



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. _____/25
Kaçanik, 19.06.2025

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VI (gjashtë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 30.06.2025 (e hënë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e VI (gjashtë) të Kuvendit të Komunës të datës 30.06.2025, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2026-2028;
3. Propozim Rregullore për transportin rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;
4. Propozim Rregullore për transparencë e komunës së Kaçanikut;
5. Plani i veprimit për transparencë e komunës së Kaçanikut;
6. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2025.
7. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “MUJA“ O.P;
8. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SH.P.K;
9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P “X-PLAST”;
10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “NTP GREEN PRODUCT”;
11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “XHEMILE VISHI.B.I”;
12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T “LYPETENI”;
13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I.;
14. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “ERA PLAST SH. P. K”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr.060/01-8444/25
Kaçanik, 29.04.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V (pestë) e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 30.05.2025. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përberja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye, Rustem Zenuni.

Nga Ekzekutivit i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Suhad Dullovi- DBPZHR, Qamil Stagova-DUKMM, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Zahir Doda- DA, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Valdrin Dogani-Zyrtar Kryesor Financiar-ZKF, Fatlume Guri-Selimi-Zyra e Informimit, Maviye Murseli-Zyra e Kryesuesit, Makfire Malsiu-Zyra e KK.

Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit

Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Se pari iu përshëndes të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, prezentë janë 26, me arsye mungon Rustem Zenuni. E hapi mbledhjen e pestë të rregullt të KK për vitin 2025, data 30 maj, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2025;
3. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik;
4. Kërkesa e MBPZH për harmonizimin e Rregullores Nr. 02/2025 për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale, të Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
5. Kërkesa e MMPHI 3745-2/25 për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.06-350/01-8267/25 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut, të datës 29.04.2025;
6. Kërkesa e MMPHI 1359-2/25 për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.104/02-3943/25 për miratimin e Planin Ndër komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, të datës 27.02.2025.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Të pika 6, në kuadër të shqyrtimit të materialit të kësaj pike, kam vërejtur se është paraqitur një gabim teknik, e cila ka nxjerrë në pah parregullsitë të mundshme në lidhje me vendimin e datës 24.12.2024, konkretisht vendimin për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit nga objektet ndërtimore -mbeturinat inerte. Në këtë

drejtim kërkoj sqarim nga zyrtarët, kryesuesi i KK dhe përfaqësuesit e ekzekutivit se çfarë konkretisht është bërë me vendimin e datës 24.12.2024. A ka pasur iniciativë nga MAPL për rishqyrtim të këtij vendimi. Nëse ka pasur, pse nuk e keni sjellë në KK për shqyrtim? Unë nuk e kam pa që është kthyer kjo pikë, por në këtë raport kjo pikë e rendit të punës e njerrë në pah edhe këtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Jemi duke folur për rendin e punës, ndërkaq të pyetjet dhe kërkesat mund të trajtohet pyetja e juaj, për sqarim për vendimin e 24.12.2024 nga drejtori. Të pika 6, është materiali se për cilin vendim është fjala, ndërkaq se është gabim i ministrisë, e kanë pranuar edhe ata vet. Nëse ju kujtohet, e kam potencuar në KK, se vendimi ka ardhur për rishqyrtim të ligjshmërisë, por ka ardhur me vonesë. Zyrtarët e ekzekutivit të komunës kanë komunikuar me ministrinë, dhe përgjegjësia është e qartë se mbi kënd bie. Në qershor na vjen edhe raporti i performancës, aty i shohim se cilat vendime na kanë ardhur në rishqyrtim dhe koha kur kanë ardhur.

znj. Kadrije Lika-Troni: Në emër të grupit të anëtarëve të LVV dua të ndajë me ju disa shqetësime.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse keni diçka rreth rendit të punës, urdhëro. Mos kaloni në tema tjera, se jemi në rendin e punës.

znj. Kadrije Lika-Troni: Rendin e punës nuk e keni shtruar ende në votim, kështu që me dëgjoni të flas.

Kryesuesi i Kuvendit: Mos dilni në tema që nuk janë në rend pune.

znj. Kadrije Lika-Troni: Në seancën e kaluar, kur flisnim për çështjen e sigurisë në komunë, Kryetari i komunës-Besim Ilazi, që është edhe kryesues i KKSB, e lëshoj mbledhjen dhe i ikur përgjegjësisë institucionale, me raportuar në KK para qytetarëve. Nuk pati guxim as përgjegjësi me u përballur me ne, aq me pak për qytetarët që presin siguri. Edhe me keq, u mbështet nga shumica e anëtarëve të pozitës për me lëshuar mbledhjen dhe duke i ikur debatit. Ndërkaq, ky veprim i pahijshëm i kryetarit, nuk u përfshi në procesverbal, transmetimi i drejtpërdrejtë i kësaj seance mungoj, e sot e asaj ditë nuk është transmetuar në faqen zyrtare të komunës dhe askush nuk jep sqarime për këtë. Kryesues, për pikat e rendit të punës, qytetarët nuk janë të informuar se çka kemi diskutua këtu. Qysh me vazhdua ne tutje këtu. Po ashtu, pyetjet tona të çdo seancë mbesin pa përgjigje, duhet t'i përsërisim 3-4 herë dhe prapë ngelin në heshtje. Nëse institucionet nuk janë transparente në llogaridhënie, atëherë çfarë mesazhi po iu japim ne qytetarëve? Prandaj, ne si LVV refuzojmë të legjitimojmë këtë lojë politike që përbuzë transparencën dhe llogaridhënien. Në shenjë proteste e lëshojmë këtë seancë.

Me këtë rast, shtatë (7) anëtarë të LVV, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Bashkim Luma, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Burim Shehu, Naim Beça e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi i Kuvendit: Shtatë (7) anëtarë të LVV e lëshuan mbledhjen, vazhdojmë me punimet e mbledhjes, prezentë janë 19 anëtarë.

z. Kadri Krivenjeva: Edhe ju kryesues keni vërejtje, se KK e ka një rregullore, ku janë të përcaktuara rregullat për mbajtje të seancës, janë të përcaktuar minutat për folësit.

Kryesuesi i Kuvendit: Mundeni me dalë me udhëhequr mbledhjen, nëse mendoni se është ashtu. Pasi po e dini qysh me udhëheq mbledhjen, me tregoni qysh duhet me udhëhequr?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi : Janë të paarsyeshme vërejtjet e LVV, nuk mundesh me u kuptuar me ta.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk keni mirëkuptim me dëgjuar njëri tjetrin, nëse nuk keni mirëkuptim me diskutua sipas rendit të punës, unë nuk mundemi me marrë askënd me nxjerrë jashtë, se përpara dal vet nga seanca.

znj. Ardita Rrahmani: Po kryesues, por po krijohet një standard i dyfishtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Me tregoni atëherë si me vepruar?

znj. Ardita Rrahmani: Ju duhet me gjetur alternativën, jo unë. Unë nuk jam në pozitën e juaj që me iu treguar si me vepruar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me njëzëri për. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës prej 6 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

znj. Ardita Rrahmani: Po e ritheksoj edhe njëherë, kritikën, për arsye se në një takim që kemi pasur ditë me parë, e kam vënë në theks, po e ritheksoj përsëri: Përse nuk është transmetua seanca e mbledhjes së kaluar, edhe pse gjatë seancës kemi kërkuar pse nuk po transmetohet seanca drejtpërdrejtë? Keni thënë se për shkak të disa problemeve transmetohet me vonë në Youtube, por kjo nuk ka ndodhur. Edhe në procesverbal nuk është përfshirë i gjithë diskutimi i seancës së kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit: Transmetimi është rregulluar, me herët ka pasur pengesa, tani po me njoftojnë se është në rregull. Sa i përket procesverbalit, nëse pritni me u shënuar secila pikë dhe presje, është e pamundur, për shkak se nuk ka mundësi, ndërkaq nëse është hequr diçka qëllimshëm, mundeni me ngritur si shqetësim vërejtjen të sekretaria e KK. Në procesverbal mundohet me u përfshirë në vija të trasha në kuptimin e plotë ashtu si duhet, pa përjashtuar ndonjë pjesë që nuk mundet me u përfshirë. Ne kemi kontakte që kemi me sekretari të KK, nuk besoj se ka zyrtar me të përgjegjshëm për këtë çështje, qëllimisht nuk bëhet asgjë, por ato që duhet me u përfshirë, duhet të përfshihen në procesverbal. Atëherë, Procesverbalin e mbledhjes së kaluar e Kuvendit të Komunës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua pa ndonjë vërejtje konkrete, me 18 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj Raif Kasa. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IV (katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, të datës 29.04.2025/Lënda:1Nr.060/01-8444/25.

Kryesuesi i Kuvendit: Konstatoj me kaluar në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Ardita Rrahmani: I kam 3 pyetje për këtë mbledhje:

1. Kur do të filloni të shihni rrugën drejt urës së xhamisë së dëshmorëve si hapësirë ka nevojë për mirëmbajtje. Po flas për hapësirën rreth lumin nerodime, hapësirë e cila nuk është aspak e mirëmbajtur, ndërkaq kjo rrugë është tejet e frekuentuar nga qytetarët.

2. Sanimi imediat i rrugës së dëmtuar tek laura, në drejtim të lagjes Dushkajë dhe rrugës “Skënderbeu”, ETC dhe rrugës “Mukadeze Lika”. Ajo pjesë mund të jetë e INFRAKOS, por nuk e kam të qartë qëndrimin indiferent ndaj kësaj rruge. Qytetarët kalojnë çdo ditë me vështirësi në atë rrugë, e mos të flasim për automjetet, që dëmtohen çdo ditë gjatë kalimit nëpër atë rrugë.

3. Kur do të bëhet emërtimi i Palestrës sportive të qytetit, se ka kohë që në këtë KK është thënë se është në procedurë? Sa zgjasin procedura dhe çfarë janë ato procedura që zgjasin me vite? Jemi komuna e vetme që palestra sportive ende është e pa emërtuar.

z. Agim Çaka: 1. Hapësira e sipërme e QKMF, a menaxhohet nga QKMF? Nëse ajo hapësirë menaxhohet nga QKMF, pse ajo pjesë është e pambikëqyrur dhe e pa trajtuar mirë? Ajo pjesë paraqet një gjendje të pa menaxhuar mirë, apo të keq menaxhuar, aty ka mbeturina që i japin një pamje jo të mirë asaj pjese. Nëse ka ndonjë vendim nga KK ajo pjesë me u shfrytëzuar për diçka tjetër, është mirë me ditur, ose duhet me sjellë atë çështje përsëri në KK.

2. Në këtë kohë është aktuale çështja e rrezikut të qytetarëve nga gjarpërinjtë helmues. Pyetje: A është e furnizuar QKMF me vaksinë kundër helmit të gjarpërinjve? Këtë pyetje po e bëjë, për me ditur saktë se nëse ndodhë ndonjë rast, a ka vaksinë në QKMF që me u orientuar në QKMF? Nëse nuk ka vaksinë në QKMF, atëherë me u orientuar diku tjetër.

3. Pyetje për DSHPE: Gjendja në Bulevardin “Ismail Raka” është në gjendje të keqe, sidomos gjatë orëve të natës. Aty ka lëvizje të makinave, parkim të makinave, motor të parkuar, tavolina në trotuar, ka kanta të mbeturinave. A e keni ndërmend me rregulluar këtë çështje apo ka me vazhduar edhe tutje kështu?

z. Betim Shala: E kam bërë një kërkesë në mbledhjen e kaluar, për vendosjen e policëve të shtrirë në rrugën “Skënderbeu”, për shkak se në njërën anën, pjesën me të madhe, trotuari është hequr, në anën tjetër është i ngushtë 60-80cm, rruga është midis dy shkollave, shkollës së mesme ‘Skënderbeu’ dhe shkollës “Emin Duraku” në Dushkajë. A munden me u vendosur ato pengesa dhe nëse po, të intervenohet sa me shpejtë që është e mundur?

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe kërkesat tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese. Prezentë 18, nuk është Raif Kasa.

2. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, në tabela janë dhënë qartë gjendja e mjeteve të mbledhura dhe të shpenzuara. Drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Para se me marrë fjalën dikush, fillimisht ia jap fjalën drejtorit të DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Fillimisht e jap si sqarim se e kemi plotësuar Propozim Vendimin, i cili është shpërndarë tani juve nga Sekretaria e KK. Janë disa ndryshime që po bëhen nga ministria për çështje teknike të procedurave. Ju e dini që vitin e kaluar janë bartur mjetet automatikisht, ndërkaq na kanë dalë probleme në ekzekutim të buxhetit të vitit të kaluar. Tani një pjesë e mjeteve bartën në këtë vit buxhetor. Përpara, arsyetimet i jepnim në bazë të shkresave që i dërgonim në ministri, pas miratimit të vendimeve. Ndërkaq tani, kanë kërkuar që çdo arsyetim, të cekët në vendim. Këto ndryshime i kemi bërë dhe ua kemi sjellë tani materialin e korrigjuar. Ndryshimi nuk ka të bëjë në vlerat për bartje, por vetëm janë dhënë arsyetimet, se asnjë cent nuk ka ndryshuar nga propozim vendimi që e keni pasur më herët. Për pyetjet që keni, ju përgjigjem në vazhdim.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Pyetja ime është: Pse kjo shumë kaq e lartë e bartjes së mjeteve buxhetore, shuma mbi 1 milion euro?

z. Agim Çaka: Nuk e di nëse është gabim teknik, apo lëshim, të pika 2. shënon shuma e mjeteve të bartura të vitit 2023 në vitin 2025, është 409,873.41€, pastaj bartja e mjeteve nga viti 2024 në vitin 2025, është 623,167.70€. Ndoshta janë gabime teknike, por nuk është mirë me u lëshuar gabime të tilla. Nëse është shuma e bartur nga 2023-2004, atëherë i bien me u shënuar shuma totale 1,033,041.11€.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk janë gabime teknike, por kështu janë.

z. Bahri Selimi: Të HVK që tha Arlinda, janë shumë mjete të bartura, për shkak se inkasimi që bëhet në tre muajt e fundit, nuk mund të shpenzohen në atë vit. Në 2-3 vitet e fundit, komuna ballafaqohet me rrezikun apo sfida e mëdha që vijnë nga kontrata kolektive në arsim. Edhe aty tërhiqen mjete herë pas here në projekte kapitale, por ne fokusim e kemi me shpenzuar grantin qeveritar, i cili është realizuar gati 100% çdo vit. Të HVK jo që nuk mundemi me i shpenzuar nëpër kategori tjera, por është edhe si politikë e ruajtës së mjeteve, për me ruajtur stabilitetin financiar në vitin vijues. Kjo shumë e mjeteve 1,033,041.11€ të bartura, ndihmojnë tepër në këtë situatë, sepse vetëm në vitin e kaluar, janë shpenzuar mbi gjysmë milioni euro nga kontrata kolektive nëpër projekte, edhe pse janë projektuar, ndarë buxheti, janë tërhequr për kontratën kolektive të arsimit, në shumicën e projekteve apo mbi gjysmën e tyre. Të arsyetimi që e sjella, shumica e mjeteve të bartura, kanë të bëjnë me plotësimin e atyre ndarjeve buxhetore të mëhershme, të cilat janë ekzekutuar, e tani ne duhet me i plotësuar në tërësi. Të pyetja e Agimit, tani nuk po i bartim vetëm të HVK të vitit paraprak, por edhe të vitit 2023. Shumat e potencuar të bartura të vitit 2023 dhe të vitit 2024 janë në rregull.

z. Agim Çaka: Shuma e bartur nga 2023 deri 2024 është 409,873.41€, ndërkaq nga vitit 2024 në vitin 2025, janë 623,167.70€, që në total janë 1,033,041.11€. Nëse nuk shpenzohen këto mjete, llogaritën si mjete të vitit 2025.

z. Bahri Selimi: Agim, të pika 2, teksti në fund të pikës, mjetet që nuk janë shpenzuar të cilat janë bartur nga viti 2023 në vitin 2024, lejohet me u bartur në vitin 2025.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: A ka përfunduar ekzekutimi i shpenzimeve të kontratës kolektive, pasi që çdo herë po lidhet krejt raporti financiar me kontratën kolektive?

z. Bahri Selimi: Drejtori i DA është këtu për sqarime me në detaje. Ekzekutimi i shpenzimeve sipas kontratës kolektive nuk ka përfunduar, janë diku edhe 2 milion euro obligime, borgji vazhdimisht po rritet. Kur vonohet ekzekutimi, janë shpenzimet e përmbaruesit, kamata etj. Ka vendime që janë në gjykatë, ato nuk mundemi me i shpejtuar edhe me i pasur mjetet, ndoshta mjetet kthehen, por ti nuk mundesh me i shpenzuar, se lënda është në gjykatë- në apel e ku ta di unë.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Si duket edhe vitin tjetër, kemi me u përballë me këtë problem?

z. Bahri Selimi: Ky vit dhe viti tjetër, kemi me pasur obligime, përpos nëse del ndonjë obligim tjetër.

z. Selajdin Troni: Drejtor, i pamë bartjet e propozuara, janë të specifikuara mirë në projekte, me kod të projekteve, si rrugë, kanalizime, ndriçim, trotuar, kështu që kjo është një punë e mirë që është bërë. Ju përgëzoj për punën që keni bërë. Ne po punojmë, nuk po sabotojmë, me këto paga të larta, kolegët tonë nuk janë asnjëherë me punuar për qytetarët tanë. Nga partia jonë PDK konfirmoj se këto bartje të mjeteve përkrahen.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenim 2: Arlinda Rakoci-Raka dhe Betim Shala. Prezentë 17. Nuk është Kadri Krivenjeva. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2025/Lënda: 01Nr. 104/02-11055/25.

3. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Selajdin Troni: Nëse ka mundësi me na dhënë sqarime të nevojshme, se nuk e kam të qartë për çka është duke u bërë u bërë shpallja e interesit të kësaj prone dhe a ka me u formuar ndonjë komision për këtë çështje?

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo zonë ka me u shpallë interes publik, për me hapur një rrugë rreth ETC, të Xhamia e dëshmorëve, ashtu qysh e ka potencuar drejtori në KPF. Drejtori është këtu, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Qamil Stagova:

z. Qamil Stagova: Është fjala për një pronë prapa ETC, e cila me lagjen e Dushkajës kanë arritur një marrëveshje me pronarin e tokës Nasa Hollding, ai ka me bërë ndërtim të objekteve shumë banesore. Ne e kemi paraparë që para rregullimit të tyre, ndërtimin e një rruge në atë pjesë, që do t'na krijonte mundësinë me liruar lagjen Dushkaja. Për me qartësuar, rruga është të ura e Aziz Bungut, në të djathtë, shkon drejtë, nuk vazhdon të vendkalimi hekurudhor, por vazhdon drejtë të ura të xhamia.

z. Agim Çaka: A ka probleme ajo pjesë me PZHK e vjetër, a ka qenë e paraparë me plan me u ndërtuar aty diçka tjetër?

z. Qamil Stagova: Me herët ajo pjesë ka qenë për Qendër rekreative sportive, por asaj prone iu ka ndërruar destinimi, kur u ndërtua qendra tregtare aty. Në bazë të ligjit për ndërtim dhe rregullores, ajo pjesë i plotëson kushtet qysh kanë objektet tjera në largësi 50 metra. Në anën tjetër të rrugës, kemi objekte në largësi edhe me të vogël.

znj. Ardita Rrahmani: Për derisa po parashihet me u bërë kjo rrugë, numri i qytetarëve që e shfrytëzojnë pjesën tjetër të rrugës, mundet me u rritur, se kemi numër të banorëve nga f. Runjevë që vijnë edhe këmbë. A parashihet me u bërë një urë për këmbësor dhe automjete të Xhamia e Dëshmorëve.

z. Qamil Stagova: Sigurisht, se rruga nuk do të jetë asnjëherë funksionale, pa u ndërtuar një urë aty.

Kryetari i Komunës: Aty parashikohet me u ndërtuar urë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 18. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-10931/25.

4. Kërkesa e MBPZH për harmonizimin e Rregullores Nr. 02/2025 për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale, të Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

Kryesuesi i Kuvendit: Në rregullore, nuk është përfshirë një taksë e DBPZHR, edhe të DSHMS ka qenë një gabim teknik, është gabuar ligji. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 18. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës vendosi të,

HARMONIZOJ

Rregulloren Nr. 02/2025 e aprovuar me 29.04.2025 -për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale, të DBPZHR të neni 25 dhe të DSHMS, të neni 28/ Lënda: 01Nr. 104/02-8228/25.

5.Kërkesa e MMPHI 3745-2/25 për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.06-350/01-8267/25 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut, të datës 29.04.2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Të ky vendim, ligjshmëria është kthyer, pasi është kërkuar që fillimisht lënda me shkuar në Agjencinë kadastrale për verifikim, pastaj me ardhur në KK për miratim. Drejtorja sa kam informacion, e ka dërguar në agjencinë, por nuk ka përgjigje ende për verifikimin e listës për emërtimin e rrugëve. Kështu që ne mund të shtyjme vendimin për mbledhjen vijuese, derisa të vjen vendimi nga Agjencia kadastrale. Vendimi duhet të pezullohet, deri me përgjigjen nga Agjencia kadastrale. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Ndoshta duhet me pezulluar vendimin, se në kalkulime që i bëra, jemi në 6 mujorin para zgjedhjeve. Nëse e shfuqizojmë, vendimin e lëshojmë në zero, kështu nuk ka nevojë me shfuqizuar, por e shtyjme deri me marrje të përgjigjes.

Kryesuesi i Kuvendit: Duhet me kërkuar interpretim edhe njëherë, se edhe 6 mujori para zgjedhjeve, nuk është bash i specifikuar për me marrë vendime të kësaj natyre.

Kryetari i Komunës: Unë jam me shtyrë vendimin deri me marrjen e një përgjigje nga Agjencia kadastrale.

Kryesuesi i Kuvendit: Përpos kësaj që është kërkuar me u dërguar në agjenci, nga ministria edhe disa vërejtje tjera (i lexoj vërejtjet e theksuara në vlerësim të ligjshmërisë), besoj drejtori i ka analizuar.

z. Qamil Stagova: I kanë pasur parasysh, se kemi qenë në kontakt me Agjencinë kadastrale të Kosovës, skicat janë dërguar në agjenci. Kërkesën e kam adresuar në Agjencinë kadastrale të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit: Në kërkesën e ministrisë, thuhet se mungon skica e formës së rrugëve.

z. Qamil Stagova: Për rrugët të cilat janë emërtuar, janë dërguar skicat në Agjencinë kadastrale.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që vendimi të Pezullohet deri në kthimin e përgjigjes nga Agjencia kadastrale e Kosovës? Njëzëri votuan të gjithë Për. Prezentë 18. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për PEZULLIMIN e Vendimit 01 nr.06-350/01-8267/25 të datës 29.04.2025 për emërtimin, riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut/Lënda: 01Nr. 104/ 02-11566/25.

6. Kërkesa e MMPHI 1359-2/25 për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.104/02-3943/25 për miratimin e Planin Ndër komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, të datës 27.02.2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, me ka njoftuar me tel. se e kanë arritur një harmonizim me ministrinë për me trajtuar vendimin. Para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani:

z. Ramadush Osmani: Plani ndër komunal për menaxhimin e mbeturinave është një proces i ri, edhe për ministrinë ka qenë një sfiduese sesi me vepruar. Ne kemi pasur takim edhe me përfaqësues të zyrës ligjore të MAPL dhe MMPHI, për arsye se ka një diskrepancë të madhe

me vendimin që po marrin. Ne si komunë nuk kemi dashur të kontestojmë afatin ligjor, sepse edhe vendimi për shqyrtim të ligjshmërisë ka ardhur pas afatit ligjor, është dërguar në MAPL me 5 mars. Ajo që duhet me u diskutuar, jemi në kontakt edhe me GIZ- kompani e angazhuar për përgatitjen e këtij plani, ka të bëjë me të gjeturat teknike, të cilat janë përmirësuar, mirëpo pjesa që MMPHI e konteston është afati i debatit publik, të cilën ne si komunë kemi qenë brenda afatit ligjor prej 15 ditëve, për shqyrtim të këtij dokumenti, që është e rregulluar me ligj dhe rregullore. Këta kanë kërkuar që vlerësimit i ndikimit në mjedis për këtë plan, të shqyrtohet përmes ligjit për ndikim në mjedis, që është 30 ditë me qenë dokumenti në faqe të komunës, pastaj me dhënë ministria pëlqimin për këtë plan. Si KK ju vlerësoni se: A duhet të shfuqizojmë apo të ngrijmë derisa të kryejmë procesin të gjitha komunat për VSM. Nga 1 qershori jam i detyruar të publikoj edhe një herë VSM për këtë plan, 30 ditë do të qëndroj dokumenti në faqe të komunës, ku do të mbajmë debatin pse e kemi diskutuar se është plan ndër komunal dhe ka mundur të mbahet vetëm një debat publik për të gjitha komunat, por për mos me komplikuar shumë punën, jemi detyruar që nga qershori fillojmë me çështjen e vlerësimit të ndikimit në mjedis, pastaj dokumentin e sjellim për miratim edhe njëherë në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka me ardhur edhe njëherë në KK, e shfuqizojmë, pastaj pasi të kryeni procedurat e nevojshme, e bini në KK për miratim. Nëse e pezullojmë, ne nuk kemi nevojë me trajtuar me. E hapi diskutimin:

z. Ramadush Osmani: Nuk është problem, nuk me pengon edhe nëse nuk shfuqizohet, se merret një vendim në mbledhjen kur ofrojmë lëndën.

z. Agim Çaka: Për mua është shqetësuese për vendimet që po na kthehen me shumë vërejtje nga ministria, se këto nuk janë vërejtje teknike të vogla, por vërejtje bukur të rëndësishme. Kjo të bënë me kuptuar se kur po hartohen këto vendime, dikush nuk është i përgatitur mirë për përpilimin e atyre vendimeve. Nisur prej të parës, po shihet se legjislacioni sekondar nuk është në përputhje me legjislacionin primar, nuk është në përputhje me aktet e ndryshuara. D.m.th dikush nuk po i përcjellë ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore që po ndodhin, si KK po mbesim pa i marrë do vendime të rëndësishme për qytetarët e këtij vendi dhe për interesin e tyre në përgjithësi. Vërejtja është se kur po bëhen këto vendime, ai që po merret me përgatitjen e tyre, nuk është i përgatitur sa duhet.

z. Ramadush Osmani: Ato janë vlerësime të një anëtarit të KK. Ky dokument, është dokument i përbashkët i 12 komunave dhe është model i përbashkët dhe përmbajtësor për 12 komuna dhe është i mbështetur nga ekspert dhe kompanisë së angazhuar nga GIZ për hartimin e tij. Grupet teknike kanë asistuar nga secila komunë. Të gjitha komunave iu ka kthyer kështu blanko, me të njëjtin tekst “kopi paste”. Nuk desha me dalë të ajo që e potencoj me herët anëtarit i KK, por ku është serioziteti i kësaj ministrie, sepse në këtë vlerësim të ligjshmërisë, shkruan, shqyrtimi i ligjshmërisë për planin ndër komunal, ndërkaq në arsyetim shkruan për një vendim krejt tjetër. Kjo tregon sa është serioze ministria dhe sa dinë. Tjetra, KK miraton akte komunale dhe shkojnë në ministri për vlerësim të ligjshmërisë. Vlerësimi i ligjshmërisë nënkupton: A kam pasur unë të drejtë si komunë me strategjinë e Kosovës me marrë këtë hap apo jo? Ndërkaq ata kanë shqyrtuar lekturën, çështje teknike, por nuk jemi duke u marrë me ato. Jemi në proces të ri, duhet të iu përshtatemi kërkesave që janë apo nuk janë në pajtim me të. Po e ritheksoj edhe njëherë, dokumenti është i hartuar nga ekspert të jashtëm, këto të gjetura i përmirësojmë dhe vazhdojmë.

z. Agim Çaka: Këto janë vërejtje të ministrisë, jo të miat. Nëse ju mendoni se unë jam kundër këtij vendimi që mundemi me penguar këtë proces, e keni gabim. Sa për mua, dërgoni përsëri kështu vendimin, por nuk kalon. Për atë unë po themi se, ata ministrisë kanë gjetur vërejtje dhe janë kompetente me dërguar vërejtje.

z. Ramadush Osmani: Atë që theksove që dikush po i bënë këto vërejtje, unë ju tregova se kush është ai.

z. Agim Çaka: Edhe ligji mundet me qenë i keq dhe i papërshtatshëm për qytetarët, por përderisa është ligj në fuqi, ai duhet me u respektuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne e kemi sjellë me Shfuqizuar, përndryshe nuk e kishim sjellë hiq në KK. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 18. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr.104/02-3943/25 të datës 27.02.2025 për miratimin e Planin Ndër komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, të datës /Lënda:01Nr. 104/02-10165/25.

Kryesuesi i Kuvendit: Për fund iu jap një, Njoftim: Ne e kemi ftuar një trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të familjes së Skënderbeut, që të jetë me 4 qershor në Kaçanik, ku do të mbajmë një mbledhje në sallë të KK me këtë datë, në ora 11:00. Kushdo që ka shprehë vullnet, mundet me marrë pjesë. Ai është tani studiues dhe gazetar i njohur italian. Ai ka me bërë një prezantim të gjeologjisë së familjes Skënderbeu, në periudha prej kohës së Skënderbeut deri ma tani. Ai ka me marrë pjesë edhe në ceremoninë e diplomimit të maturantëve të gjimnazit ‘Skënderbeu’.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 11:54. Nga 27 anëtarë të KK, në mbledhje ka munguar me arsye 1 anëtar, shtatë 7 anëtarë të LVV (Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Bashkim Luma, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Burim Shehu, Naim Beça) e lëshuan mbledhjen në të gjitha pikat, ndërkaq anëtari Raif Kasa doli nga mbledhja në ndërkohë- duke filluar me pikën 2. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 18 anëtarë.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Departamenti i Financave dhe Buxhetit
Departament za Finansije
Department of Finance and Budget

01Nr.400/01-13692/25
Kaçanik; 16.06.2025

PËR/ZA/TO:	KUVENDIN KOMUNAL, KRYESUESIN Z.KEMAJL MËRSELI
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Bahri Selimi – Drejtor për Buxhet dhe Financa; ZKF – Valdrin Dogani
NGA/OD/FROM:	Besim Ilazi – Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2026-2028



I nderuar,

Përmesë kësaj shkresë, ju dorëzojmë Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) për periudhën e viteve 2026 -2028, sipas kufijëve fillestarë të përcaktuar me Qarkoren Buxhetore të MFPT 2026/01.

KABK si dokument shumë i rëndësishëm për planifikimin afatmesëm dhe strategjik, është hartuar në bazë të kufijëve fillestar të përcaktuara me Qarkoren e parë buxhetore 2026/01 të lëshuar nga MFPT.

Bashkangjitur shkresës:

1) Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

K O R N I Z A
A F A T M E S M E
B U X H E T O R E (KAB) E
KOMUNËS SË KAÇANIKUT
2026-2028

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Qershor, 2025

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

2.1. Përshkrimi i komunës dhe profili ekonomik

2.2. Vizioni i Komunës

2.3. Objektivat dhe Prioritetet Afatmesme

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Burimet e Financimit Komunal për vitet 2026 – 2028

3.2 Tendencat e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2026-2028

I. Hyrje

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajit prill të këtij vitit, ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Qeveritare (KASH) për periudhën 2026 – 2028.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH 2026-2028) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2026. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë, e cila reflekton mjedisin makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë. Në përgjithësi, ky dokument strategjik përmban dhe shtjellon katër kapituj kryesorë si vijon:

- Deklaratën e prioriteteve afatmesme 2026-2028,
- Kornizën Makrofiskale,
- Korniza e shpenzimeve sektoriale 2026-2028 – QEVERIA QENDRORE
- **Niveli komunal - Burimet e Financimit Komunal për vitet 2026-2028**

Pas hartimit nga Ministria e Financave të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2026–2028), pason edhe Qarkorja Buxhetore për gjitha Organizatat Buxhetore mbi bazën e së cilës të gjitha OB-të njoftohen mbi instruksionet e hartimit të buxheteve të tyre për periudhën 2026 – 2028.

Qarkorja Buxhetore 2026/01 ofron udhëzimet e para të përgatitjes së buxhetit komunal, përfshirë këtu kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestarë të financimit për komunitet për periudhën 2026 – 2028. Bazuar në kufijtë fillestarë të përcaktuara nga Qarkorja Buxhetore, autoritetet komunale janë angazhuar në përgatitjen e KAB të Organizatës Buxhetore '652' Komuna e Kaçanikut.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale - KABK, siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KABK siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2026/01 të pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2026-2028.

KAB Komunal, është dokumenti i parë që i prinë procesit të hartimit të Buxhetit pas pranimit të Qarkores së parë Buxhetore që lansohet nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për çdo vit. Kalendarin kohor të procesit buxhetor sipas udhëzimeve të Qarkores Buxhetore 2026/01 po e paraqesim si vijon:

-Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës);

-Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-Buxhetit komunal për vitin 2026-2028, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare;

-Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP);

-Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2026-2028 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF);

-Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2026 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitet 2026-2028 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF);

-Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF);

-Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinnor.

Më në detaje kemi paraqitur më poshtë fazat e procesit buxhetor komunal 2026:

1. Përgatitja e Komizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028:

- Dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike.

2. Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale:

- Kryetari i Komunës, Drejtori i Buxhetit dhe Financave si dhe drejtorët e drejtorive komunale bëjnë shqyrtimin e politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre sektoriale.

3. Kufijtë fillestarë specifik për programet buxhetore:

- Rekomandohet se kufijtë fillestarë specifik të programeve duhet të percaktohen para datës 01 Korrik 2025 bazuar në projeksionet e vendosura të Qarkores 2026/01, MFPT.

4. Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve:


- Drejtorët e drejtorive bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve, përfshirë politikat e reja si dhe opsionet për kursime të mundshme.

5. Dëgjimet buxhetore:

- Seanca dëgjimore ne secilën drejtori komunale me qëllim te shqyrtimit të buxheteve të propozuara si dhe dëgjime publike të hapura me publikun.
- 6. Shqyrtimi i buxhetit komunal nga Kuvendi Komunal:**
- Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dorëzon propozim-buxhetin në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe aprovim, jo më vonë se 01 Shtator 2026.
- 7. Aprovimi i buxhetit te propozuar nga K.Komunal dhe dorezimi në MFPT:**
- Propozim buxheti komunal per vitin 2026 i aprovuar nga Kuvendi Komunal dorezohet në MFPT deri më 30 Shtator 2026.

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Kaçanikut përfshin pjesën juglindore të Republikës së Kosovës me sipërfaqe prej 211.13 km², përkatësisht 1.94 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës (10,887 km²). Komuna e Kaçanikut përbëhet prej 31 vendbanimeve, 1 me karakter urban dhe 30 rurale, ndërsa kufizohet me Komunën e Vitisë, Ferizajt, Shtërpçës dhe në jug me komunën Hani Elezit dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në regjistrimin e popullsisë të vitit 2024 në Komunën e Kaçanikut ka 27,716 banorë.

Nëpër Kaçanik kalojnë dy lumenj, lumi Lepenc dhe lumi Nerodime, të cilët bashkohen në fund të qytetit dhe kalojnë tok grykën piktoreske të Kaçanikut.

Kaçaniku ka edhe pasuri natyrore të pyjeve, tokës dhe ujërave, ndërsa vlerësohet si një ndër vendet më të pasura shqiptare me pyje të bollshme e të bukura. Qyteti i Kaçanikut është i pasur me objekte të

trashëgimisë kulturore, natyrore e historike. Ky qytet njihet në histori për qëndresën kombëtare në luftë kundër armikut në të gjitha etapat e historisë sonë të lavdishme.

Në Kaçanik, ndër të tjera ekzistojnë kushte te volitshme për zhvillimin e industrisë, blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë e në veçanti kushte të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv, veror dhe malor.

Nëpër Kaçanik kalon magjistralla Prishtinë – Shkup dhe hekurudha Fushë Kosovë – Selanik, e ndërtuar në vitin 1879 e cila tani është duke u rikonstruktuar në tërësi, ndërsa fakti tjerët se komuna e ka edhe vendkalimin kufitar në fshatin Gllloboçicë – e bënë Kaçanikun vend të rëndësishëm dhe strategjik në rrafshin ekonomik, turistik dhe të bashkëpunimit ndërkufitar etj.

Kaçaniku ka resurse të mëdha natyrore e sidomos mineraleve të ndryshme si gurë gëlqeror, argjilë por edhe minerale tjera të cilat deri më tani nuk janë hulumtuar.

2.1. Përshkrimi i komunës dhe profili ekonomik



Nga perspektiva e zhvillimit ekonomik, Komuna e Kaçanikut aktualisht karakterizohet me një ekonomi jo edhe aq të zhvilluar. Kjo për faktin se kjo komunë ka kaluar nëpër një periudhë ndryshimesh që kanë ndikuar negativisht në zhvillim ekonomik. Ndër proceset që kanë ndikuar në rritjen e papunësisë dhe që e ka dëmtuar rëndë ekonominë e kësaj komune janë privatizimi i ndërmarrjeve publike, me ç'rast janë shkurtuar shumë vende të punës, si dhe krijimi i Komunës së re të Hanit të Elezit, që ka ndikuar në zvogëlimin e pronës publike Komunale. Në veçanti dëm ka sjellë edhe shpëputja nga aspekti territorial i gjigantit ekonomik fabrika "Sharr Cem" e cila gradualisht ka zëvendësuar edhe stafin vetëm me banorë të komunës në të cilën operon, kjo ka rezultuar në rritje të numrit të papunësisë në komunën e Kaçanikut.

Përfundimi i luftës së fundit po ashtu e ka lënë ekonominë dhe infrastrukturën lokale në gjendje mjaft të rëndë. Megjithatë, gjatë periudhës së pasluftës vërehen përmirësime të dukshme në këtë komunë. Ekonomia lokale e Kaçanikut tradicionalisht bazohet në industrinë ndërtimore. Vlerësohet se ekziston potencial mjaft i mirë për të zhvilluar bujqësinë, bletarinë, pemëtarinë, zanate të ndryshme, si dhe tregje turistike të dimrit dhe verës.

Edhe sipërmarrja individuale ka traditë të gjatë të veprimit në Kaçanik, specifikisht ajo e përpunuesve të drurit, gërryerjes së gurëve si dhe ajo artizanale që përfshinë rrobaqepjen, artarët dhe përpunuesit e drurit dekorativ.

Buxheti i pamjaftueshëm komunal, po ashtu ka qenë pengesë për nxitje të një zhvillimi më të hovshëm ekonomik të ekonomisë lokale. Deri më tani, qeverisjet komunale lokale të komunës kanë qenë të detyruar të angazhohen dhe ti orientojnë mjetet financiare të dedikuara për projekte kapitale në drejtim të rregullimit, ndërtimit dhe asfaltimit të rrugëve të ndryshme në territorin e komunës, mirëmbajtjen e tyre, ndërtimin e shumë kanalizimeve fekale e atmosferike, ndërtimin e objekteve arsimore, shëndetësore si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.

Nga niveli Qëndror deri më tani është arritur mjaft thithja e investimeve kapitale për komunën e Kaçanikut, mirëpo ende mungon qasja e duhur nga niveli qendror për balancim socio – ekonomik në nivel rajonesh, jemi dëshmitarë të një zhvillimi të hovshëm të qendrave rajonale por jo edhe komunave më të vogla si pjesë e këtyre rajoneve. Kjo për arsye se janë angazhuar shumë projekte kapitale në drejtim të komunave më të mëdha si pasojë edhe e ndikimeve politike, si rezultat i një sistemi disfavorizues për komunat me numër më të vogël të banorëve, pra pamundësia e përfshirjes në vendimmarrje në aspektin ekzekutiv qeveritar dhe atë legjislativ në nivelin qendror.

Buxheti i pamjaftueshëm komunal, ka qenë pengesë për nxitje të një zhvillimi më të hovshëm ekonomik të ekonomisë lokale. Deri më tani, qeverisjet komunale lokale të komunës kanë qenë të detyruar të angazhohen dhe ti orientojnë mjetet financiare të dedikuara për projekte kapitale në drejtim të rregullimit, ndërtimit dhe asfaltimit të rrugëve të ndryshme në territorin e komunës, mirëmbajtjen e tyre, ndërtimin e shumë kanalizimeve fekale e atmosferike, ndërtimin e objekteve arsimore, shëndetësore si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.

Nga niveli Qëndror deri më tani është arritur mjaft thithja e investimeve kapitale për komunën e Kaçanikut, mirëpo sidomos viteve të fundit mungon qasja e duhur nga niveli qendrorë për balancim socio – ekonomik në nivel rajonesh, jemi dëshmitarë të një zhvillimi të hovshëm të qendrave rajonale por jo edhe komunave më të vogla si pjesë e këtyre rajoneve. Kjo për arsye se janë angazhuar shumë projekte kapitale në drejtim të komunave më të mëdha si pasojë edhe e ndikimeve politike, si rezultat i një sistemi disfavorizues për komunat me numër më të vogël të banorëve, pra pamundësia e përfshirjes në vendimmarrje në aspektin ekzekutiv qeveritar dhe atë legjislativ në nivelin qendror.

Sektori i bujqësisë është njëri nga shtyllat më me influencë dhe paraqet potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të komunës. Kaçaniku ka kushte mjaft të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtysë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës. Potencialet për zhvillim ekonomik janë shfrytëzuar

relativisht pak deri më tani, ndërsa burimi kryesor i gjenerimit të të hyrave për qytetarët e komunës së Kaçanikut janë prodhimtaria e vogël, ekonomitë familjare dhe tregtia. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme.

Nga të dhënat që posedon Qendra Komunale për Regjistrimin e Biznesit deri në qershor të vitit 2025, ushtrojnë aktivitete biznesore gjithsej 1616 ndërmarrje. Nga bizneset e regjistruara 61.27% janë Biznese Individuale ndërsa 38.30% biznese Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe pjesa tjetër përfshin Shoqëritë Aksionare - Ortakëritë, Bizneset e huaja dega në Kosovë etj. Ndërmarrjet të cilat kanë pronar të gjinisë femërore janë 19% (tipi biznesit tek pronaret femra fokusohet me shume ne biznese individuale) ndërsa pronaret meshkuj përfshin rreth 81% te bizneseve. Viteve te fundit ka rritje te bizneseve te tipit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Sektorët ekonomik dominues janë kryesisht tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitetet shërbyese dhe ndërtimtaria. Tregtia përfshinë 31% të ndërmarrjeve, aktivitetet shërbyese 27%, ndërtimtaria 11%, ndërsa 31% përfshihen sektorët tjerë. Këta sektorë janë shquar për rritje gjatë viteve të fundit, ndërsa rënie nuk është shënuar në asnjë sektor. Përkundër potencialeve të Kaçanikut për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet fare pak i përfaqësuar, me vetëm 4%.

Dominimi i sektorit privat është një tregues i ndërmarrësisë në nivel komunal, i cili ka nevojë për përkrahje të mëtjme, duke pasur parasysh edhe potencialet lokale.

Numri më i madh i ndërmarrjeve është i përqendruar në Kaçanik, si qendër komunale. Në zonën urbane janë të koncentruara 49% të numrit të ndërmarrjeve në nivel komunal. Vendbanimi i dytë për nga numri i ndërmarrjeve është fshati Doganaj 6%, e pasuar nga Kaçaniku i Vjetër, Dubrava etj. Gjatë viteve të fundit, përgjithësisht numri i ndërmarrjeve në të gjitha vendbanimet është rritur, përveç në disa fshatra të vogla ku numri ka mbetur konstant.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMUNËS

Sa i përket funksionimit institucional të Komunës së Kaçanikut, sikur edhe në të gjitha komunat tjera në Republikën e Kosovës, qeverisja lokale është e organizuar në dy shtylla, ekzekutivi, që përbëhet nga zyra e kryetarit, drejtorive dhe stafi tjetër, dhe legjislativi, që përbëhet nga Kuvendi i Komunës.

Kryetari i komunës është autoriteti më i lartë ekzekutiv në komunë dhe zgjidhet direkt nga qytetarët. Aktualisht, ekzekutivi kryesohet nga Kryetari i komunës dhe Nënkryetari. Së bashku me zyrën e Kryetarit të komunës, janë nëntë drejtori të udhëhequra nga drejtorët e drejtorive:

- Administratë e Përgjithshme;
- Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari;
- Buxhet dhe Financa,
- Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm;
- Arsimit;
- Kulturë, Rini dhe Sport;
- Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Shërbime Publike dhe Emergjencë;
- Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;

Kuvendi Komunal ka 27 vende (Anëtar të Kuvendit), që përfaqësojnë 5 subjekte politike. Të 27 anëtarët janë shqiptarë të Kosovës dhe 10 prej tyre janë femra.

2.2 Vizioni i Komunës

Vizioni i Komunës së Kaçanikut definohet me *“nivel të lartë të zhvillimit ekonomik, me një bujqësi, industri dhe turizëm të zhvilluar, me mjedis të qëndrueshëm dhe komunitet të shëndetshëm, mirë të arsimuar, me rini aktive në kulturë dhe sporte dhe me kushte të mira për punë dhe jetesë.”*

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Kaçanikut i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna deri më tani.

Vizioni

"...Kaçaniku të arrijë nivel të lartë të zhvillimit ekonomik, me një bujqësi , industri dhe turizëm të zhvilluar, me mjedis të qendrueshëm dhe komunitet të shëndetshëm, mire të arsimuar, me rini aktive në kulturë e sporte dhe me kushtet të mira për punë dhe jetesë."



Forcimi i ekonomisë lokale & Përmirësimi i infrastrukturs publike.

- ▶ Përmirësimi i ambientit lokal afarist dhe sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.
- ▶ Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike.

Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë dhe mbrojtja e mjedisit

- ▶ Krijimi i të ardhurave për fermeret dhe popullatën rurale
- ▶ Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit

Krijimi i komuniteteve të fuqishme, aktive

- ▶ Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve.
- ▶ Ofrimi i asistencës sociale për familjet me gjendje të rëndë ekonomike.
- ▶ Rritja e Standardeve në arsim dhe e nivelit të arritjeve.
- ▶ Përmirësimi i kushteve dhe shtimi i aktiviteteve kulturore-sportive.

Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive dhe profesionale

- ▶ Përmirësimi i shërbimeve të ofruara për qytetarët

- ▶ Infrastruktura bashkëkohore për funksionimin e administratës

Forcimi i ekonomisë lokale & Përmirësimi i infrastruktures publike

Objektivat e përgjithshme ekonomike dhe infrastrukturore për komunën janë:

- **Përmirësimi i ambientit lokal afarist dhe sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik ;**
- **Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike.**

Kaçaniku ka një numër të avantazheve për nga karakteri ekonomik. Kemi një lokacion tërheqës, me lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore dhe një pikëkalim kufitar të madh në Gilloboçicë dhe tjetri në afërsi të komunës së Hanit të Elezit. Posedojmë furnizim të pasur me lëndë të parë për industrinë e ndërtimit, drurit dhe ujit. Ne kemi në dispozicion një forcë punëtore të arsimuar mirë, dhe një numër të bizneseve të vogla private që zhvillojnë aktivitet me sukses.

Jemi duke punuar shumë dhe do të vazhdojmë në këtë drejtim për të forcuar rritjen tonë ekonomike, dhe për të bërë Kaçanikun një vend edhe më të përshtatshëm dhe më tërheqës për bizneset lokale – vendore, me theks të veçantë për investime të huaja, këtë qëllim do ta arrijmë përmes krijimit të politikave të mira (të lehta – pa burokraci) zhvillimore lokale.

Në kuadër të politikave tona ekonomike, ku si prioritet kemi rritjen e numrit të të punësuarëve, jemi duke identifikuar edhe disa hapsira të pershtatshme për krijimjemi në proces të dhënjes së disa parcelave komunale në shfrytëzim me afatë të gjatë bizneseve, përmes këtij procesi presim shtim të numrit të vendeve të reja të punës si dhe rritje të prodhimit – përmirësimit të ambientit ekonomik lokal.

Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Përmes kësaj qendre komuniteti i biznesit mund të regjistrojnë apo themelojnë veprimtarinë biznesore vetëm përbrenda 2-3 orëve. Poashtu përmes saj bëhet edhe ofrimi i informatave për investitorët potencial, gjithashtu ipen këshilla ndaj bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese në plotësimin e aplikacioneve të ndryshme si plan biznese etj, me qëllim të qasjes më të lehtë në financa apo mjete fikse që mund të përfitohen nga donatorët e ndryshëm.

TURIZMI Kaçaniku është njëra ndër komunat më të bukura në Kosovë që ka potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit , e sidomos turizmit malorë. Përkundër potencialit turistik që posedon vendi ynë, deri më tani, kjo fushë nuk është parë me prioritet, dhe si e tillë ka nevojë për më shumë investime, në mënyrë që të promovohen më shumë bukuritë natyrore dhe kulturore që ka vendi ynë.

Komuna e Kaçanikut, përkundër buxhetit të vogël që ka në dispozicion, është munduar që sado pak të krijoj kushte më të mira dhe të promovoj vendet me potencial turistik.

Komuna jonë në vazhdimësi do të jetë e përkushtuar në përkrahjen e projekteve që kanë për qëllim promovimin e turizmit, ndërsa presim përkrahje edhe nga niveli qendror, në mënyrë që të kemi sa më shumë projekte të tilla. Kjo duke u bazuar që tashmë çështjet e turizmit në rajon po edhe në mbarë botën po shihen me prioritet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.



Fshati turistik Strazhë shtrihet në lartësinë mbidetare 1000-1080 metra në veri-perëndim të Kaçanikut dhe është e rrethuar me më shumë se 150 hektarë pisha të llojeve të ndryshme. Strazha shquhet për bukuritë natyrore paraqet një destinacion mbresëlënës për të gjithë vizitorët. Për shkak të vlerave turistike që ka, është shpallur monument natyre- peizazh i mbrojtur.

PRIORITETI 1 - Forcimi i ekonomisë lokale & Përmirësimi infrastrukturës publike:

Objektivi 1: Përmirësimi i ambientit lokal afarist dhe sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik		
Veprimet:	Matësi ► Caku:	Programi – Drejtoria përgjegjëse:
1. <i>Funksionalizimi i zonave ekonomike dhe industriale.</i>	Plotësim i infrastrukturës së nevojshme si: qasje me te lehtë rrugore, paisja e zonave me trafo elektrike dhe hidro sistem. Zonat-pronat komunale në shfrytëzim të investitorëve (conform ligjit përkatës). Themelimi i bizneseve te reja. Hapja e vendeve të reja pune.	Drejtoria e Buxhetit dhe Financave. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe

		Mbrojtjes së Mjedisit. Komisionet përgjegjëse të themeluara nga Kuvendi Komunal.
2. Ofrimi i lehtësirave për themelimin dhe ushtrimin të aktivitetit afarist	Subvencionimi i bizneseve, promovimi i tyre. Shkurtimi i kohës për themelim biznesi për vetëm 2 -3 orë. Rritja e numrit të bizneseve lokale	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
3. Hartimi i strategjisë së re afatmesme 2025-2029 për Zhvillim Ekonomik Lokal	Analiza sektoriale: identifikimi i potencialeve/resurseve të reja dhe strategjike, gjetja e mundësive për investime të reja, bashkëveprim me organizatat e ndryshme. Promovimi i potencialeve tona, thithja e investimeve të reja. Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
4. Përmirësimi i infrastruktures tek zonat ekzistuese turistike, caktimi dhe funksionalizimi i zonave të reja turistike.	Rritje e zhvillimit ekonomik nga turizmi Restaurim i monumenteve historike. Hartimi i projekteve strategjike. Ekzistimi i hartës turistike në qytet për orientimin e vizitorëve. Investimi në vendet me potencial të zhvillimit të turizmit. Rritja e numrit të vizitorëve.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Objektivi 2: Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike		
Veprimet:	Matësi ► Caku:	Programi – Drejtoria përgjegjëse:
1. <i>Ndërtimi, asfaltimi, riparimi dhe pastrimi i rrugëve.</i>	Ngritja e standardit dhe kualitetit jetësor të qytetarëve nga numri i madhë i rrugëve të ndërtuara, asfaltuara dhe riparuar. Shtimi i ndërtimit të trotuareve.	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
2. <i>Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë.</i>	Sanimi, rikonstruimi dhe shtimi i kapaciteteve ujore në rrjetin e ujësjellësit në fshatra dhe qytet. Zgjerimi i rrjeteve të reja të ujësjellësit në zonën urbane dhe rurale. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve të pamenaxhueshme ekzistuese të ujësjellësit përmes kompanisë përgjegjëse KRU" Bifurkacioni"-njësia e Kaçanikut	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
3. <i>Ndërtimi i rrjeteve të ndriqimit publik</i>	Zgjerimi i rrjetit në zonën urbane dhe rrugët e fshatrave. Zbatimi i masave eficiente në rrjetet ekzistuese përmes projektit "Smart City"	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
4. <i>Ndërtimi i kolektoreve kryesor për largimin e ujrave të zeza përgjatë lumit Nerodime dhe Lepenc.</i>	Ruajtja e shëndetit, pastrimi i lumenjëve, ambientit dhe krijimi i kushteve për të favorshme për turizëm rural.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Objektivat e përgjithshme bujqësore dhe mjedisor për komunën janë:

- **Subvencionimi i vazhdueshëm i sektorëve të bujqësisë;**
- **Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit.**

Kaçaniku disponon me resurse të mjaftueshme natyrore:

Disponon me 7,462.70ha. të tokës së punueshme që përdoret për të siguruar ushqim të mjaftueshëm për kafshë dhe për kultivimin e kulturave lavërtare - grurë, misër, perime dhe kultura përmëtare si: mollë, dardhë, kumbull, mjedër, manaferra etj.

Prej sipërfaqes së përgjithshme të territorit të saj (21,126.00ha) 14,449.09ha. është tokë pyjore, prej tyre 8,963.26ha. janë me pronësi publike dhe 3,485.28ha. janë me pronësi private. Menaxhimi i pyjeve bëhet nga Agjensioni Pyjor i Kosovës (APK).

Ka burime natyrore të mjaftueshme të ujit nga Malet e Sharrit, për furnizim të qytetarëve me ujë të pijes, si dhe rrjedhje të mjaftueshme të përrojeve, përrockave si dhe dy lumenjëve të cilët kalojnë nëpër territorin e komunës sonë (Lumi Lepenc dhe Nerodime), te cilet shfrytëzohen për ujitjen e kulturave bujqësore gjë që favorizon edhe më shumë zhvillimin e bujqësisë.

Fermat janë në pronësi private, janë të vogla dhe të ndryshme. Fermerët duhet orientuar drejtë krijimit të fermave gjysmëkomerciale dhe komerciale me synim rritjen e rendimentit si dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore sipas standardeve të BE-së.

Një nga sfidat kryesore që do të kërkojmë të adresojmë do të jetë ruajtja e sipërfaqeve të tokës bujqësore nga ndërtime ilegale (ndertimet pa leje të objekteve) gjë që do të ndikon në humbjen (zvogëlimin) e sipërfaqeve të tokës bujqësore.

Së bashku me nivelin qendror (MBPZHR), ne kemi mbështetur fermeret financiarisht për prodhimtarinë e kulturës së grurit, misrit, ngritjen e plantacioneve të pemëve (mollës dhe mjedrës), përkrahjen e kulturave perimore në ambiente të mbyllura (serra) si dhe stimulimin e fermerëve me lopë qumështore, ku si synim kemi që edhe në të ardhmen të vazhdojmë të përkrahim fermeret në këto sektorë.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë për ne ka rëndësi të veçantë, si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në përgjithësi. Si rezultat i mbështetjes së këtij sektori të ardhurat neto në fermë janë rritur ndjeshëm. Sektori i Bujqësisë, përmes politikave dhe strategjive të zhvillimit do të jetë edhe në të ardhmen e orientuar në mbështetjen e faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe krijimin e një ambienti më të favorshëm zhvillimor.

periudhën e vitit 2025:

“Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor freza 1.6m për tërheqje me traktor 15.078.00€

“Mbështetja e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50m² , në vlerë 27,000.00€

“Mbështetja e fermerëve me shoqëri bletësh, 24,000.00€.

“Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor në vlerë prej 40.000.00€

Në periudhën afatmesme 2025-2027 kemi mbështetur fermeret me mjete financiare për prodhimtarinë e kulturës së grurit, ngritjen e plantacioneve të pemëve (arrë), përkrahjen e kulturave perimore në ambiente të mbyllura (serra), stimulimin e fermereve makina mjelës për lopë qumështore si dhe mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor (freza, spërkatëse të grurit, shpërndarëse të plehut mineral, etj.) ku si synim kemi qe edhe në të ardhmen të vazhdojmë ti përkrahim fermeret në këto sektorë.

Sa i përket investimeve në bujqësi për periudhën e lartëcekur kemi investuar sipas projekteve të planifikuara me planin e punës së ekzekutivit të Komunës. Në mbështetje të fermerëve kultivues të grurit, në sipërfaqe prej 0.40-1.00 ha , përfitues 115 fermerë, mbështetja të fermerëve me mekanizëm bujqësor freza 1.6m. për tërheqje me traktor (31 fermerë), moto kultivator me freza dhe kosë (192 fermerë), shpërndarëse të plehut mineral (10 fermerë), dhe makina spërkatëse për grurë –misër(10 fermerë) përfitues 243 fermerë, në sektorin e pemëtarisë, për periudhën e lartëcekur, deri më tani kemi mbështetur fermerët në ngritjen e planacioneve me arrë, përfitues 9 fermerë, në sektorin e perimkulturës kemi investuar me serra, përfitues 308 familje (1540 m² sipërfaqe me serra apo 1.50.40ha.). Në sektorin e blegtorisë kemi mbështetur fermerët me makina mjelëse, përfitues 30 fermerë .Gjithashtu kemi mbështetur edhe bletarët me koshere bletësh dhe me centrifugaelektrike për nxerrjen e mjaltit, përfitues 52 bletarë. Në periudhën e lartëcekur kemi mbështetur gjithsejtë 860 fermerë. Vlera e shpenzimeve në subvencione për fermerët për periudhën raportuese është 518,454.70 €, duke llogaritur edhe participimin e fermerëve 20% të shumës së përgjithshme dhe mbështetjes nga OJQ Relief Islamit në vlerë prej 187,930.67€, projektin e serrave dhe mbështetjes së fermerëve me motokultivator si dhe OJQ Church Jezus Krisht 37,000.00 € në projektin me bashkëfinancim për ndërtimin e serrave. Ndërsa permes buxhetit nga investimet kapitale kemi ndertuar kanalet e ujitjes ne fshatrat: Soponicë, Doganaj dhe Nikaj. Ndërsa gjatë vitit aktual 2025 jemi ne realizim te projektit “Ndertimi i kanalit te ujitjes” ne fshatrat Nikaj, Dubravë dhe Vatë. Realizimi i ketyre projekteve ka per qellim krijimin e lehtësirave fermereve me qëllim te ujitjes se sipërfaqeve të mbjellura me kultura bujqësore si dhe shfrytëzimin me racional të ujit.

Gjatë tre viteve vijuese 2026-2028 planifikojmë ti ndajmë afër 400,000€ nga ndarjet e reja buxhetore për fermerët tonë si mbështetje në sektorët e bujqësisë (Lavërtari, pemëtari, perimkulturë, blegtori dhe bletari etj). Në sektorin e lavërtarisë do ti stimulojmë prodhuesit e kulturës së grurit për mbjellje të sipërfaqes prej 0.40-1.00 ha me mjete financiare në shumë prej 250 €/ha, mbështetja e fermerëve në blerje të mekanizmit bujqësor(freza, motokultivator, spërkatëse të grurit, kositëse rrotative, makina mbjellëse të misrit, makina mbjellëse të grurit, makina mbjellëse të patates etj.) Mbështetja ne sektorin e pemëtarisë do të jetë ngritja e plantacioneve të reja me arra dhe lajthi, e pemë tjera sipas kërkesave të fermerëve. në perimkulturë rritjen e sipërfaqeve me serra, në blegtori do të mbështesim fermerët që nuk përfitojnë nga projektet e subvencionimit të MBPZHR me mjete financiare me nga 50 € për krerë për lopë qumështore, mbështetje e bletarëve do të jetë në ushqim për bletë e preparate për mbrojtjen e tyre si dhe paisje të nevojshme për bletë).

Gjithashtu permes investimeve kapitale, synohet te permbyllet rregullimi i kanaleve te ujitjes në lokacione te ndryshme. Vlera e gjithmbarshme e projekteve kapitale per kete qëllim do te jetë nga 50,000.00 euro deri në 80,000.00 euro për secilin vit.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë per ne ka rëndësi të veçantë, si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të

jetës së qytetarëve në përgjithësi. Si rezultat i mbështetjes së këtij sektori të ardhurat neto në fermë janë rritur ndjeshëm. Sektori i Bujqësisë, përmes politikave dhe strategjive të zhvillimit do të jetë edhe në të ardhmen e orientuar në mbështetjen e faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe krijimin e një ambienti më të favorshëm zhvillimor.

Në territorin e Komunes sonë, kryesisht kultivohen kulturat lavërtare: grurë 480 ha, misër me fasule 120 ha, misër për kokërr 350 elb 5ha, tërshëra 15 ha, patate 40 ha si dhe kulturat perimore kultivohen vetëm për plotësimin e nevojave familjare, tepicën e [prodhimeve e qesin në treg (prodhimtari ekstensive). Sa i përket pemëtarisë kemi 53 ha. plantacione me pemë: molle, arrë, dardhë, lajthi si dhe pemë të imëta mjedër, krahasuar me vitet e para luftës kemi një rritje të sipërfaqeve. Blegtoria në komunën tonë, pas lufte ka një rënie të fondit blegtoral: deleve, lopëve qumështore e sidomos buallicave. Bletaria është dukshëm më e zhvilluar krahasuar me vitet e para luftës dhe kemi një rritje në fondin e shoqërive me bletë.

Sa i përket shfrytëzimit të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore, pjesa dërmuese shfrytëzohen livadhe dhe kullosa, e që paraqet një potencial të mirë për zhvillimin e blegtorisë dhe bletaris. Bazuar në madhësinë e parcelave që disponon, komuna jonë ka kushte për zhvillimin e pemëtarisë dhe perimekulturës.

Edhe pse Kaçaniku është komunë që ofron potencial për zhvillim të bujqësisë, numri i ndërmarrjeve bujqësore është tejet i ulët, numri total i ndërmarrjeve të regjistruara bujqësore përbën vetëm 4% të ndërmarrjeve në komunë. Numri aktual i të punësuarve në ndërmarrje bujqësore është 90, që tregon përgjithësisht për kapacitete të vogla të ndërmarrjeve, dhe strukturim kryesisht familjar. Kjo tregohet edhe sipas regjistrimit të fundit të ekonomive familjare (2011) ku vetëm rreth 2.5% të punësuarve janë angazhuar në bujqësi, vlerë e cila është shumë e vogël krahasuar me potencialin.

Bujqësia sot zhvillohet vetëm në sektorin privat, kryesisht në bujqësi familjare, për krijimin e të ardhurave shtesë në familje, me parcela të vogla private bujqësore, me mekanizëm bujqësor të vjetruar (amortizuar). Sipërfaqet e tokës bujqësore ku kanë mundësi të ujitjes (ujitja e kulturave bujqësore- lavërtare bëhet përmes kanaleve të hapura të ujitjes të ndërtuara me mure prej betoni, me investime komunale) ndërsa të kulturat pemëtare dhe perimore ujitja bëhet përmes sistemit pikë-pikë të ujitjes. Viteve të fundit ka filluar përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit, ndërsa nevojat për përkrahje janë ende më të mëdha se mundësitë buxhetore.

Toka bujqësore - Sipas të dhënave nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, bazuar sipas regjistrimit të vitit 1958, sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore është 7642.70 ha, tokë lavërtare 3086.86 ha (41.37%), livadhe 2008.25ha.(26.91%) dhe kullosë 2367.53 (31.72%). Nga sipërfaqja e përgjithshme cekur më lartë, 5051.95 ha (67.70%) ha janë në pronësi private, ndërsa 2410.75 ha (32.30%) ha në pronësi shoqërore dhe komunale. Sa i përket shfrytëzimit, 773 ha (25%) e tokave lavërtare janë të kultivuara (kryesisht grurë dhe misër në përzierje me fasule), ndërsa shumica dërmuese e atyre sipërfaqeve janë shndërruar në livadhe dhe kullosa. Niveli i kultivimit të tokave bujqësore është edhe një tregues i shfrytëzimit të pamjaftueshëm të potencialit bujqësor. Livadhet dhe kullosat përfshijnë 4375.78 ha, pa i llogaritur edhe pjesën e tokës lavërtare, që pas lufte së fundit një pjesë është shndërruar në tokë ndërtimore dhe në livadhe e kullosa.

Prodhimtaria bujqësore - Niveli i prodhimit të drithërave në Kaçanik ka treguar ndryshime viteve të fundit. Ky nivel ka lëvizur prej 3.5 t/ha deri në 4.5 t/ha te gruri, te misri prej 5t/ha deri në 6.5 t/ha, që shënon një rritje prej 1-1.5 t/ha, shprehur në % kemi një rritje prej 30%. Llojet që kultivohen më së

shumti janë gruri me 52.63 % dhe misri me 38.78%, patate 4.15% dhe perime 4.43% Kultivimi i foragjereve përfshinë vetëm jonxhën, që kultivohet në gjithsej 60 ha. Sipërfaqet e kultivuara me perime përfshijnë vetëm 32 ha. Dominojnë sipërfaqet me spec me 40.62%, domate 37.5%, tranguj 3.75 %, qepë 12.5% dhe llojet tjera 5.63%. Vlen të theksohet se kultivimi i perimeve bëhet kryesisht për plotësimin e nevojave familjare, vetëm tepicën e prodhimeve e shesin në tregun lokal, (prodhues komercial kemi në numër shumë të ulët). Sipërfaqet e kultivuara me pemë përfshijnë 51ha. kryesisht (plantacione të reja të ngritura pas luftës së fundit), sipërfaqet e kultivuara me mollë përfshijnë 65.68%, (të sipërfaqes së përgjithshme prej 51 ha), me mjedër 15.68% , me arrë 8.43%, me dardhë 5.88% dhe llojet tjera 4.33 %. Vlen të theksohet se sipërfaqe me pemë ekzistojnë shumë më tepër, por janë në formë shkapërderdhura dhe nuk disponojmë me të dhëna të sakta lidhur me sipërfaqen për ha.

Prodhimtaria blegtorale - Sa i përket kapaciteteve blegtorale, komuna karakterizohet me dominim numerik të gjedheve. Numri i përgjithshëm i gjedheve është 4297, përkatësisht 3648 lopë dhe 649 mëshqerre; numri i deleve është 3432 krerë, ndërsa i dhive 245 krerë. Niveli mesatar i prodhimit të qumështit ka arritur në 12593.09 litra/dit. Numri i shpezëve (pula dhe gjela) është 31086 krerë.

Pyjet Sipas të dhënave nga komuna, tokat pyjore përfshijnë 12449.09 ha. E tërë sipërfaqja pyjore kategorizohet si e mbrojtur, pa destinim për ndonjë qëllim komercial. Shumica e sipërfaqeve publike pyjore janë të dëmtuara (të prera) ilegalisht për nevoja të industrisë së drurit në Ferizaj dhe për djegie nga banorët e rajonit të Ferizajt ku përfshihet edhe Kaçaniku. Nuk ka ndonjë sipërfaqe e cila shfrytëzohet për qëllime komerciale. Sa i përket llojit të drurit, dominon ahu, lisi dhe shkoza por ka edhe pishë, frashër, etj.

PRIORITETI 2 - Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë dhe mbrojtja e mjedisit:

Objektivi 1: Krijimi i të ardhurave për fermeret dhe popullatën rurale:		
Veprimet:	Matësi ► Caku	Programi – Drejtoria përgjegjëse:
1. Subvencionimi i sektorëve të bujqësisë dhe blegtorisë	Diversifikimi i fermave gjysmëkomerciale dhe komerciale. Rritja e punimit të sipërfaqeve të tokës bujqësore me kultura lavértare. Rritja e prodhimit të bujqësore, prodhimit të blegtorale dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore me qëllim të përmbushjes së standardeve të BE-së. Rritja e prodhimit të mjaltit.	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

	Zhvillim më i avancuar i bujqësisë.	
2. <i>Rregullimi i kanaleve të ujitjes.</i>	Krijimi i lehtësirave për fermerët, për ujitjen e kulturave bujqësore. Ndikim në rritjen e rendimentit tek kulturat bujqësore.	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
Objektivi 2: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit		
1. <i>Rritja e hapsirave gjelbëruese.</i>	Gjelbrimi i qytetit, mbjellja e drunjëve, mirëmbajtja e tyre. Mjedis i shëndetshëm, përmirësim i kushteve për jetesë.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural DUKMM, DSHPE.
2. <i>Organizimi i aktiviteteve mjedisore</i>	Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe DUKMM.
3. <i>Ndërtimi i shtratit të lumit Lepenc dhe Nerodime dhe shtretërve të përrockave</i>	Mirëmbajtja – Pastrimi i lumenjëve. Ruajtja nga erozioni Shfrytëzimi i ujit të lumit për ujtime të tokës.	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
4. <i>Implementimi i Planit të ri komunal për Menaxhim të Mbeturinave për periudhën 2024-2028 dhe Hartim i Planit ndërkomunal për Menaxhimin e integruar të mbeturinave</i>	Krijimi i infrastrukture komunale për menaxhimin e mbeturinave. Krijimi i kompanisë komunale për menaxhimin e Mbeturinave. Kompletimi i normave ligjore dhe teknike për inkasim të faturës së mbeturinave nga komuna. Reduktimi gradual i mbeturinave të rrezikshme Plotësimi-ndryshimi i Rregullores komunale për Menaxhimin e Mbeturinave	Drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave në koordinim me organizatën GIZ dhe kompaninë “Pastërtia”-njësia e Kaçanikut

	Rritja graduale e përfshirjes së popullatës në sistemin e trajtimit të mbeturinave. Kompletimi i normave ligjore për menaxhimin e mbeturinave në bazë të direktivave të BE-së Shëndritimi i deponive ilegale në hapësira gjelbra. Fillimi i zbatimit të strategjisë 3R (reduktimi, riciklimi, ripërdorimi) i mbeturinave si dhe zvogëlimi i mbeturinave përmes kompostimit	
--	--	--

Krijimi i komuniteteve të fuqishme, aktive

Objektivat e përgjithshme të sektorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale për komunën janë:

- **Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve;**
- **Ofrimi i asistencës sociale për familjet me gjendje të rëndë ekonomike.**

Jemi në drejtim të plotësimit të numrit të mjaftueshëm të mjekëve dhe me ndihmën e donatorëve, kemi përmirësuar pajisjet tona laboratorike dhe kemi bërë ndërtimin dhe renovimin e disa prej qendrave tona mjekësore. Kjo ka çuar në një përmirësim të përgjithshëm në cilësinë e shërbimeve që ne ofrojmë. Megjithatë, ne jemi të vendosur të zbatojmë lëvizjen tonë në drejtim të mjekësisë familjare. Për ta bërë këtë, ne do të duhet të caktojmë më shumë mjekë ashtu që të kemi nga një mjek në çdonjërin prej Qendrave tona të Mjekësisë Familjare, dhe do të punojmë shumë me qeverinë qendrore që të përmirësojmë prokurimin dhe furnizimin e barnave të miratuara në Komunë.

Aktualisht, shërbimet shëndetësore në komunë kryhen në nivelin parësor, i cili përfshinë Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) funksionon në Kaçanik. Ndërtimi i saj është bërë në vitin 2016/2017. Gjendja fizike është shumë e mirë dhe ofron shërbime për qytetarët 24 orë në ditë. QKMF ofron këto shërbime: ekzaminim i përgjithshëm, ekzaminime të brendshme të specializuara, pediatri, analiza laboratorike, trajtim urgjent, rreze rëntgen dhe stomatologji. Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) janë gjithsej 6 dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) janë 6.

Edhe pse infrastruktura e shëndetit publik mbulon të gjithë territorin e komunës së Kaçanikut, siç shihet edhe në tabelën e mësipërme, QMF-të nuk janë plotësisht funksionale. Mungesa e stafit profesional adekuat mjekësor dhe vështirësia për angazhimin e tyre së bashku me mungesa e pajisjeve dhe barnave janë sfidat kryesore me të cilat përballlet shërbimi shëndetësor. Shumica e njerëzve në zonat rurale duhet të udhëtojnë për në qendrën komunale për të kërkuar kujdes mjekësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare e cila duhet të përballojë një numër të shtuar të pacientëve.

Ndërsa, në kuadër të sektorit privat funksionojnë disa klinika mjekësore, shumica në Kaçanik, ku përfshihen disa klinika dentare private në Kaçanik, (1) klinikë interne dhe pediatrie, një (1) klinikë e përgjithshme mjekësore, një (1) klinikë gjinekologjike dhe një (1) klinikë ortopedike. Në fshatin Kaçanik i Vjetër funksionon një (1) poliklinikë private me shërbime të pediatrië, ORL-së dhe mjekësisë së përgjithshme.

Në kuadër të shërbimeve sociale është zvogëluar dukshëm numri i personave që marrin ndihmë sociale. Masat që jemi duke marrë ne, Administrata si e tërë, për të tërhequr biznese dhe investime, të inkurajojmë zhvillimin dhe risitë në bujqësi, si dhe promovimin e turizmit, duhet të rrisin mundësitë e punësimit dhe të zvogëlojnë nevojën për ndihma sociale. Ndërsa për familjet me nevojë për strehim të përhershëm jemi në fazën e fundit të lëshimit në përdorim nga qytetarët me kushte të rënda banimi të objektivit për banim social me kapacitet për 24 familje. Ndërsa gjatë këtij viti është i planifikuar edhe përfundimi i objektivit të dytë për këtë qëllim.

Poashtu, janë planifikuar mjetet buxhetore për ndërtimin edhe të disa shtëpive tjera përmes donatorëve siq është Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", në mënyrë që secilës familje me kushte të rënda të sigurohet banim me kushte më të mira për një jetesë më të dinjitetshme.

Prioritetet e përgjithshme arsimore për komunën janë:

- Rritja e standardeve në arsim dhe ngritja e cilësisë
- Gjithëpërfshirja dhe përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta
- Përgatitja e mësimeve për trajnimeve
- Siguria në shkollë
- Zgjerimi i hapsirave të reja dhe digjitalizimi i shkollave
- Aplikimi i masave efektive të energjisë në objekte shkollore
- Përkrahja e studentëve të dalluar

Procesi arsimor në Komunën e Kaçanikut është i organizuar në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 (Parafillor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë). Të gjitha institucionet arsimore funksionojnë në kuadër të sistemit të arsimit publik, dhe deri më tani nuk është hapur asnjë institucion arsimor privat. Në Komunën e Kaçanikut, janë 11 –Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta (ShFMU), 2-Shkolla të Mesme të Larta (ShML) dhe një kopsht publik i fëmijëve. Për krijimin e kushteve më të mira për fëmijë, në proces të ndërtimit është ShFMU "Ali Asllani" në Doganaj dhe projekte të miratuara për fillim të ndërtimit janë: ShFMU "Emin Duraku" në Kaçanik, çerdhja e fëmijëve në Rekë dhe çerdhja e fëmijëve në Kaçanik të Vjetër. Deri në vitin 2026, të gjitha shkollat amë me mbi 250 nxënës do të kenë sallat e edukatës fizike.

Të gjitha institucionet arsimore kanë qasje në internet dhe kanë kabinete të teknologjisë informative dhe pajisje tjera teknologjike të cilat janë të nevojshme për realizimin e një ore mësimore. Varësisht nga numri i nxënësve, të gjitha shkollat amë dhe dy ShML janë të furnizuara me tabela digjitale dhe nga viti 2025 planifikohet të fillohet me digjitalizim të plotë të shkollave në harmoni me Strategjinë e Arsimit 2022-2026



Niveli i mësimdhënies në Komunën e Kaçanikut çdo vit është duke u ngritur duke filluar nga niveli i Arsimit Parafillor, Fillor, i Mesëm i Ulët e deri te niveli i Mesëm i Lartë.

Në tri vitet e ardhshme prioritetet tona janë që të vazhdohet me përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, përmirësimin e kushteve të punës, zgjerimin e hapsirave shkollore, punësimin e psikologëve dhe pedagogëve në shkolla, përfshirjen e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe nga fëmijëria e hershme dhe në veçanti do t'i kushtohet rëndësi sigurisë së fëmijëve në institucione shkollore. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet trajnimit të mësimdhënësve në fusha të ndryshme në mënyrë që të përdorin pa problem teknologjinë bashkëkohore për mësimdhënie dhe për të rritur profesionalizmin dhe kapacitetin e tyre.

Prioritetet e përgjithshme kulturore për komunën janë:

- **Përmirësimi i kushteve për mbarrëvajtjen e aktiviteteve kulturore-sportive**

Në kuadër të këtij sektori synohet krijimi dhe zhvillimi sportiv, kulturor e rinor, i qasshëm nga të gjithë për mirëqenien sociale dhe promovimin, evidentimin, vlerësimin, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Sikurse shumica e komunave në Kosovë, Komuna e Kaçanikut është e varfër sa i përket ndërtesave dhe hapësirave të destinuara për aktivitete kulturore .

Objektivat kryesore të sektorit kultura, rekreacioni dhe sporti janë:

- Forcimi i mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe komplekseve memoriale;
- Shoqëri aktive dhe e shëndetshme përmes aktivitetit sportiv;
- Promovimi i imazhit lokal përmes zhvillimit të turizmit sportiv dhe kulturor;
- Shtimi i sasisë së rregullimit të lëndës arkivore dhe përmirësimi i kushteve të ruajtjes së materialit arkivor;
- Zhvillimi i ngjarjeve komunale dhe ndërkomunale kulturore dhe sportive;

Sporti dhe rekreacioni Në përgjithësi infrastruktura sportive në Kaçanik, ashtu si në nivel të Kosovës, nuk është nivel optimal. Mungesa e infrastrukturës për të gjitha disiplinat e sportit dhe financimi i kufizuar janë disa nga faktorët kryesorë sfidues në nivelin komunal. Situata në përgjithësi është jo e kënaqshme .

Palestra e qytetit është e vetmja publike në të gjithë territorin e komunës. Ajo sapo është lëshuar në punë gjatë vitit 2022 dhe është plotësisht funksionale. Në kuadër të shkollave gjenden edhe 5 palestra të tjera sportive të cilat shfrytëzohen pas orëve të mësimi. Ekzistojnë edhe 5 palestra private futsalli të shpërndara në komunë.

Në vitin 2016 ka filluar ndërtimi i stadiumit të qytetit në Stagovë. Ai është funksional, ka kapacitet mbi 8 mijë ulësesh, ndërsa posedon edhe hapësirat ndihmëse– fushën rezervë, dhomat e veshjes, projekti nuk ka përfunduar ende në tërësi .

Përveç një fushe të jashtme sportive afër palestrës, nuk ka ndonjë tjetër publike të rregulluar në territorin e komunës.

Me futjen në punë të palestrës, situata në lidhje me aktivitetet sportive është përmirësuar ndjeshëm. Megjithatë, duke marrë për bazë nevojat e përgjithshme të qytetarëve të komunës së Kaçanikut, e sidomos strukturën demografike, mund të thuhet se ka nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm të rrjetit dhe kapaciteteve sportive dhe rekreative.

Në Kaçanik operojnë klubet sportive si në vijim: klubi i futbollit “Lepenci”, 3 shkolla futboli, klubi i basketbollit “Kaçaniku”, klubi dhe shkolla e volejbollit “Kaçaniku”, klubi i hendbollit “Lepenci” dhe klubi i shahut “Lepenci”.

Trashëgimia kulturore Në komunën e Kaçanikut ekzistojnë potenciale të rëndësishme të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale. Në shumëllojshmërinë e vet kjo trashëgimi kulturore përfshinë objekte të trashëgimisë arkitekturale, arkeologjike, peizazh kulturor dhe një zonë të veçantë të mbrojtur. Numri i objekteve dhe tërësive të trashëgimisë kulturore në Kaçanik është 67.

PRIORITETI 3 – Krijimi i komuniteteve të forta dhe aktive:

SHËNDETËSIA:		
Objektivi 1: Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve		
Veprimet:	Matësi ► Caku	Programi – Drejtoria përgjegjëse
1. <i>Sigurimi i numrit adekuat të mjekëve dhe paimeve në QKMF.</i> 2. <i>Furnizimi me paisje laboratorike</i>	Ofrimi i kujdesit shëndetësor nga stafi profesional në ndërtesa të standardeve të larta. Shtimi i numrit të analizave për qytetarë, duke ndikuar edhe në kursimet e tyre financiare.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. <i>Renovimi dhe furnizimi me paisje të QKMF dhe objekteve të QMF-ve.</i>	Funksionalizimi i plotë dhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore nga QMF-të. Ofrimi i shërbimeve me afër qytetarëve. Shkarkimi i nr. të pacientëve në QKMF.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
SOCIALJA:		
Objektivi 2: Ofrimi i asistencës sociale për familjet me gjendje të rëndë ekonomike		
1. <i>Zvogëlimi i numrit të njerëzve që marrin ndihma sociale</i>	Ofrimi i trajnimeve të ndryshme për punësim dhe verifikimi i listave në vazhdimësi Ulja e shfrytëzuesëve të ndihmës sociale.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

2. Ndertimi i objekteve për banim social.	Krijimi dhe sigurimi i kushteve me të mira për jetesë i familjeve skamnore.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
ARSIMI:		
Objektivi 3: Rritja e Standardeve në arsim dhe e nivelit të arritjeve		
1. Rritja e standardeve në mësimdhënie dhe mësimnxënje	Rritja e kualifikueshmërisë së mësimdhënësve. T-rajnimi i mësimdhënësve në fusha të ndryshme. -Trajnimi i drejtorëve në fushën e udhëheqjes arsimore. -Ngritja e rezultateve nga vlerësimet e jashtme. -Zvoglimi i orëve të humbura nga nxënësit dhe mësimdhënësit. -Paisja e shkollave me mjete konkretizuese moderne. -Digjitalizimi i shkollave -Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënies në fushën e TI	Drejtoria e Arsimit
2. Gjithëpërfshirja dhe përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta	Rritja e numrit të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta Përkrahja dhe subvencionimi i shpenzimeve për fëmijët që shkollohen në qendrat burimore Trajnimi i mësimdhënësve mbështetës.	Drejtoria e Arsimit
3. Siguria në shkollë	Rritja e numrit të psikologëve dhe pedagogëve në shkollë Vendosja e kamerave të sigurisë në shkollë Në ShML angazhim të kompanive të sigurimit për siguri të ambienteve shkollore	Drejtoria e Arsimit
4. Renovimi i vazhdueshëm i objekteve shkollore dhe paisja me pajisje	Mirëmbajtja e hapsirave shkollore.	Drejtoria e Arsimit

<i>dhe teknologji te avancuar.</i>	Ndërtimi i hapsirave të reja shkollore dhe zgjerimi atyre agezistuese. Kompletimi i shkollave me salla të edukates fizike Paisja e shkollave me inventarë të nevojshëm. Paisja e shkollave me panele diellore dhe pompa termike efikiente	
5. Përkrahja e studentëve të dalluar	Bursa për studentët e dalluar Përkrahje për praktikën profesionale dhe realizim të projekteve të ndryshme.	Drejtoria e Arsimit
KULTURA, RINIA DHE SPORTI: Objektivi 4: Përmirësimi i kushteve për mbarëvajtjen e aktiviteteve kulturore-sportive.		
1. Përfundimi i ndërtimit të objekteve të reja si: "Ndërtimi i stadiumit të futbollit "Besnik Begunaca", Ndërtimi i Palestres sportive & përmirësimi i vazhdueshëm i objekteve tjera kulturore.	Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive. Shtimi i numrit të aktiviteteve sportive dhe kulturore. Përmirësimi i kushteve infrastrukturore për rinë, kulturë dhe sport. Shtimi i aktivizimit të rinisë në aktivitete kulturore-sportive dhe ulja e dukurive negative tek të rinjtë. Më shumë grupe të të rinjëve mund të ushtrojnë aktivitetet e tyre në Shtëpinë e Kulturës Shtim i numrit dhe aktivizim i klubeve sportive dhe shoqerive kulturore artistike .	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
1. Subvencionimi i aktiviteteve sportive, kulturore dhe rinore	Rritja e interesimit të të rinjëve për aktivitete kulturore dhe sportive	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive dhe profesionale

Prioriteti i komunës së Kaçanikut është ngritja e cilësisë dhe shpejtësisë në shërbimet e ofruara nga administrata e komunës. Drejtoria e Administratës ofron shërbime të rëndësishme komunale si: gjendjen civile, arkivin, qendrën për shërbim me qytetarë (QSHQ), logjistikën, zyrën për barazi gjinore, zyrën e përkthimeve, etj.

Stafi ynë dhe ndërtesat tona janë të rëndësishme - ata krijojnë një përshtypje për Komunën tonë në sytë e publikut. Është e rëndësishme që publiku të ketë një mendim pozitiv për komunën. Ne presim që i gjithë stafi jonë të jetë i dobishëm, miqësor, efikas dhe profesional.



Prioritetet tona administrative janë ofrimi i shërbimeve efektive dhe efikase për të gjithë në të gjithë Komunën, si dhe zhvillimi i e-qeverisjes.

Ne kemi ofuar 5 Zyra të Regjistrimit Civil në komunë për të bërë qasjen për qytetarë më të lehtë dhe më të shpejtë; dhe një Regjistër digjital ofron shërbime online për njerëzit dhe bizneset. Të gjitha protokollet e stafit tonë janë online.

Ne planifikojmë të implementojmë përmirësime të mëtejshme në TIK për të lëvizur drejt një "zyrë pa letra", dhe të vazhdojmë me trajnimin e stafit.

PRIORITETI 4: Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive, profesionale

Objektivi 1: Përmirësimi i shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve		
Veprimet:	Matësi ► Caku	Programi – Drejtoria përgjegjëse
1. <i>Rritja e përdorimit të TIK në kuadër të Administratës</i>	Implementimi i Planit të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve në QSHQ	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Objektivi 2: Infrastrukturë bashkëkohore për funksionimin e administratës		
2. <i>Përmirësimi i infrastrukturës së objekteve</i>	Renovimi i objektit të Administratës komunale, Ndërtimi i Parkingut Nëntokësor, Ndërtimi i Aneksit të Administratës komunale dhe krijimi i qasjes me të lehtë për të gjithë. Rritja e cilësisë gjatë zhvillimit të seancave. Shërbime të shpejta dhe cilësore sipas parimit “one-stop shop”	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Një nga synimet e administratës komunale është arritja e efikasitetit në të gjitha nivelet. Institucionet publike janë përgjegjëse për të siguruar të mirat dhe shërbimet e nevojshme publike për qytetarët pa asnjë diskriminim. Prandaj, objektivat shumëdimensionale të administratës komunale kërkojnë që performanca jo vetëm të jetë e kufizuar në ofrimin e shërbimeve, por gjithashtu të përfshijë elementin thelbësor të sigurimit të vlerave llogaridhëse për qytetarët.

Në kohën bashkëkohore, pikëpamjet e duhura se si duhet të funksionoj administrata komunale orientohen kryesisht në përparimin në teknologji që pritet të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në evolucionin e ofrimit të shërbimeve si një fushë dinamike e së ardhmes.

Drejtoria e Administratës është tradicionalisht e angazhuar në arritjen e efikasitetit në punën e dikastereve të saj, me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve. Prandaj, efikasiteti gjen një vend të përhershëm në

planin dhe programin qeverisjes lokale. Efikasiteti dhe eficientia merr një vëmendje të rëndësishme kur përpiqemi ta aplikojmë atë në një sistem që bazohet në shumë vlera, profesionalizëm e transparencë të zyrtarëve të angazhuar publik. Dimensionin e transparencës i jep një perspektivë unike efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Për arritjen e këtij qëllimi, vazhdimisht duhet të vlerësojmë performancën. Matja e performancës gjithmonë ka të bëjë me misionin dhe aktivitetet e administratës, si dhe me mjedisin në të cilin ofron shërbime. Në fakt, matjet e këtij lloji shpesh gjatë kohës shfaqen në progres.

Siç u tha më lartë, Drejtoria e Administratës përkushtimin e saj e bazon në tri shtylla: efikasitet, performancë, transparencë. Këto mekanizma janë instaluar dhe vazhdojnë të përkrahen nëpërmjet investimeve kapitale në vazhdimësi. Investime këto kryesisht në teknologji, infrastrukturë të objektit dhe investime tjera të rëndësishme.

III. Korniza Fiskale Komunale

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2026-28) për nivelin komunal ofron udhëzimet për komunitetin për përgatitjen e buxhetit për 2026 dhe orientimet për 2027 dhe 2028, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton shumën agregate të granteve qeveritare për financimin e komunave dhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2026 si dhe parashikimin afatmesëm 2027-2028.

Parimet, kriteret dhe formulat të zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2022 bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale të përgatitura nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxheti në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale si dhe,
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin e 2026 dhe projeksionet për vitet 2027 – 2028.

Buxheti i projekteve kapitale shumëvjeçare përfshinë integrimin e të dhënave të planifikuara nga komuna në sistemin e Projekteve të Investimeve publike (PIP) dhe buxhetimin në bazë të performancës.

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut është hartuar në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-Qarkorja buxhetore) 2026-2028 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasyshë. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2026-2028 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike dhe sociale të vendit.

4.1. Burimet e Financimit Komunal për vitet 2026-2028

Buxheti i Komunës përbëhen nga dy burime kryesore:

- Grantet qeveritare (GP, GSA, GSH) dhe
- Të hyrat vetanake komunale .

3.1.1 GRANTI I PËRGJITHSHËM (GP):

- Mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë buxhetore komunale,
- Është mekanizëm për sigurimin e barazisë ndërmjet komunave si dhe
- Mundëson alokim adekuat të burimeve për komunitetet pakicë në komunat përkatëse.

Bazuar nga të dhënat e Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2026 është ndarë në shumë prej 307.5 milion euro. Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përfshirë: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale. Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2026 pritet të jenë 3,227.19 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2026 është në shumë prej 307.5 milion euro.

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

- ☐ Buxheti i përgjithshëm i planifikuar i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026, i përcaktuar sipas Qarkores Buxhetore nr.2026/01 me kufijtë fillestarë buxhetor në shumë prej: 13,169,753.00€.

FINANCIMI I BUXHETIT PER VITET 2026-2028						
BURIMET E FINANCIMIT	VITI: 2025	VITI: 2026	VITI: 2027	VITI: 2028	KRAHASIMI: 2026/2025	Rritja ne%
GRANTI I PËRGJITHSHËM	5,538,386.00	5,656,269.00	6,086,568.00	6,569,239.00	117,883.00	
GRANTI S. PËR ARSIM	4,626,225.00	4,761,842.00	4,904,697.00	5,051,838.00	135,617.00	
GRANTI S. PËR SHËNDETËSI	1,477,227.00	1,686,509.00	1,737,104.00	1,789,218.00	209,282.00	
TOTAL FINANCIMI QEVERITAR	11,641,838.00	12,104,620.00	12,728,369.00	13,410,295.00	462,782.00	3.98
H V K :	950,401.00	1,065,133.00	1,142,071.00	1,146,763.00	114,732.00	12.07
TOTAL BUXHETI:	12,592,239.00	13,169,753.00	13,870,440.00	14,557,058.00	577,514.00	4.59

▪ **Burimet e financimit të Buxhetit Komunal vijnë nga:**

1. Granti i Përgjithshëm 5,656,269.00€
2. Granti Specifik i Arsimit: 4,761,842.00€
3. Granti Specifik për Shëndetësi: 1,686,509.00€ dhe
4. Të hyrat vetanake 1,065,133.00€

- **Total Financimi Qeveritar: 12,104,620.00€** apo 91.91% e përbërjes së buxhetit total dhe
- **Të hyrat vetanake që për vitin 2026 planifikohen të jenë: 1,065,071.00€** apo 8.09% e total buxhetit.

☐ **KRAHASIMI ME VITIN 2025:**

- Sipas burimeve të financimit Grantet Qeveritare kanë shënuar rritje nga 11,641,838.00€ sa ishte në v.2025 në 12,104,620.00€ për vitin 2026 apo në shumë totale prej vetëm 462,782.00 euro vlera e rritjes së buxhetit apo shprehur në përqindje rritja është për 3.98%.

Granti specifik për Arsim parauniversitar për vitin 2026-2028

Granti Specifik në nivel nacional për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2026-2028.

Granti bazë në shumë prej 265.9 milion euro si vijon:

- Paga dhe shtesa në shumë prej 247.4 milion euro,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 16.75 milion euro,

o Shpenzime kapitale në shumë prej 2.1 milion euro.

3. Politikat e reja të aprovuara janë si në vijim:

a) Transporti i nxënësve nga klasa 0-9, me kosto prej 3,48 milion euro,

b) Numri i personelit ndihmës për çerdhet e reja, rritje të stafit prej 138 dhe kosto për paga dhe shtesa prej 0.9 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2024/2025;

b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);

c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;

d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;

e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;

f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;

g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;

h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;

i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm

j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);

k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;

l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;

m) Koordinatorët e cilësisë;

n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);

o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 12,961 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

GRANTI I SPECIFIK PËR SHËNDETËSI (GSSH):

Granti Specifik për shëndetësi primare sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e shëndetësisë primare të MSH për vitin 2026-2028.

7. Në vendqëndrimet e automjeteve taksii, automjetet vendosen sipas rendit të ardhjes dhe nuk guxon të ketë më shumë automjete se që ka vende të shënuara për automjete taksii.
8. Drejtuesi i automjetit taksii nuk guxon të ofroj shërbime të transportit personalisht apo përmes ndërmjetësuesit dhe të filloj transportin jashtë vendqëndrimit të automjeteve taksii.

Neni 41

Stacionet e autobusëve

Stacioni i autobusëve është objekti me infrastrukturën e saj përcjellëse për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjes dhe rezervimin e biletave për udhëtar, gardërobën, pajisjen për informimin e udhëtarëve dhe operatorëve të transportit si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorit e transportit rrugor.

Neni 42

Kategorizimi i stacioneve të autobusëve

1. Stacioni i autobusëve nën kushte të barabarta iu ofron shërbime të gjithë operatorëve transportues që kanë rendin e udhëtimit, lejen për transport të regjistruar dhe vërtetuar në Ministrinë përkatëse për transport apo Komunë sipas tarifës të përcaktuar nga Ministria

përkatëse e bazuar në kategorinë e stacionit të autobusëve.

2. Personat zyrtar të stacionit të autobusëve janë të detyruar që në vend të dukshëm të mbajnë kartelën identifikues.

Neni 43

Detyrimet e stacioneve të autobusëve

3. Stacioni i autobusëve nuk ofron shërbime për operatorët e transportit të cilët nuk kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar nga Komuna nëse është fjala për transport urban dhe urbano- periferik,
4. Stacioni i autobusëve duhet të ketë mbishkrimin “Stacioni i autobusëve” si dhe emërtimin e vendit ku gjendet stacioni,
5. Personeli i stacionit të autobusëve është i detyruar që të mbajë librin e evidencës mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve për linjat urbane dhe urbane periferike dhe për të njëjtën gjë të raportoj në Komunë në periudha tre (3) mujore,
6. Libri i evidencës mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve duhet të ketë këto të dhëna:
 - 1.1. Emrin e operatorit të transportit;
 - 1.2. Emrin e linjës sipas rendit të udhëtimit;
 - 1.3. Koha e nisjes dhe e ardhjes së autobusit;
 - 1.4. Targat e regjistrimit të automjetit;
 - 1.5. Fleturdhëresën e rrugës (Nr. Serik),
7. Me hyrjen në fuqi të rendit të udhëtimit, stacioni i autobusëve është i detyruar të bëjë sistematizimin e të gjitha rendeve të udhëtimit sipas relacioneve, kohën e nisjes së autobusit nga stacioni i tij,
8. Licencën për stacionet për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve të transportit urban dhe urbano- periferik e lëshon Komuna.

Neni 44

Detyrimet tjera për stacionin e autobusëve

1. Stacionet dhe vend-ndaljet e autobusëve në linjat e përhershme i cakton me plan Drejtoria.
2. Stacionet dhe vend-ndaljet në linjat urbane dhe urbano-periferike duhet të jenë të rregulluara dhe të shënuara, të kenë sipërfaqe përkatëse të trafikut për ndaljen e automjetit, sipërfaqen për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e stacionit.
3. Në rrugët publike, sipërfaqja për ndaljen e automjetit parimisht duhet të jetë e ndërtuar jashtë shiritit të rrugës në pjesë të ndarë të rrugës.
4. Sipërfaqja e cila shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjeti, në rrugë apo në vendbanim, duhet të jetë e shtuar me asfalt, pllaka ose e betonuar.
5. Stacioni apo vend-ndalja në linjat në të cilat intervali i qarkullimit është më i gjatë se 15 minuta duhet të kenë nën pullazet.

Neni 45

Mirëmbajtja

1. Për rregullimin e stacioneve dhe vend-ndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave kujdeset Drejtoria.
2. Drejtoria mund të bënë shkëputjen ose transferimin e stacionit dhe të vend-ndaljes, nëse kjo është në interes të organizimit më të mirë dhe sigurisë në trafik.

Neni 46

Rendi në stacione, vendndalje dhe në automjet

1. Automjetet patjetër ndalen në të gjitha stacionet, përkatësisht vendndaljet e linjave të tyre.
2. Nëse automjeti nuk ka vende të lira, personeli i automjetit ka për detyrë të njoftoj udhëtarët për këtë.

Neni 47

1. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit e jep personeli i automjetit.
2. Vetëm personeli i automjetit hap dhe mbyll dyert e automjetit.
3. Personeli i automjetit nuk guxon të jap shenjë për nisje deri sa të konstatoj se janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje të udhëtarëve.

Neni 48

1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve behët vetëm në stacionet e autobusëve dhe në vendndaljet e destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit dhe me Plan të Transportit Publik.
2. Operatorët e transportit Publik të udhëtarëve nuk ju lejohet të ndalen në rrugë dhe të kryejn shërbime në hyrjen dhe daljen e udhëtarëve jashtë stacionit të Autobusëve dhe vendndaljeve e autobusëve.
3. Transportuesi është i obliguar të ndalet në të gjitha vendndaljet të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.

Neni 49

Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të mbajë rrobat (uniformën) zyrtare ose kartelen identifikuese dhe ndaj udhëtarëve të ketë sjellje korrekte.

Neni 50

1. Udhëtarët hyjnë në automjet në dyert e shënuara për hyrje dhe zbresin në dyert e shënuara për dalje.
2. Personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna, personat me fëmijë deri në 5 vjeç, inspektorët e trafikut, policët në uniformë dhe personat me autorizime të veçanta, mund të hyjnë në dyert e daljes.

Neni 51

1. Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtari duhet të ketë biletën e udhëtimit, biletën e parapagimit apo leje tjetër valide të udhëtimit.
2. Udhëtari është i obliguar që me kërkesën e personit të autorizuar, të tregoj biletën përkatëse të udhëtimit.

Neni 52

Transportuesi në trafikun publik urban dhe urbano - periferik të udhëtarëve, është i obliguar që të jap biletën e udhëtimit, në bazë të së cilës udhëtari fiton të drejtën për udhëtim si dhe biletën e bagazhit, nëse paguhet kompensim i veçantë për të.

Neni 53

1. Udhëtari i cili është gjetur, përkatësisht që gjendet pa biletë udhëtimi në automjet, është i obliguar që me kërkesë të personit të autorizuar, të bëj kompensimin e biletës dhe gjobën në lartësi të dhjetëfishit të çmimit të biletës.
2. Nëse udhëtari refuzon të bëj pagesën, nga paragrafi paraprak, detyrohet që personit të autorizuar t'i jap të dhënat e sakta për identitetin e vet.

Neni 54

Drejtuesi i automjetit është i obliguar të respektoj itinerarin e linjës, të cilin duhet t'a ketë në automjet.

Neni 55

Drejtuesi i automjetit në transportin linjor të udhëtarëve nuk mund të ndalë – parkoj automjetin në stacionin e nisjes dhe në peronim, më gjatë se 20 minuta.

Shërbimi i Transportit me mjete bartëse (Merimangë)

Neni 56

1 Shërbimi i transportit me “merimangë” nënkupton tërheqjen – bartjen e automjeteve të marrura ku është ndaluar qëndrimi i tyre nga vendet ku ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ose që mund të jenë të braktisura dhe në raste të tjera dhe vendosja e tyre për këtë qëllim.

2 Vendin, lokacionin për vendosjen e automjeteve nga paragrafi paraprak e cakton Komuna e Kaçanikut.

3. Mënyrën e organizimit të bartjes së automjeteve me “merimangë” e përcakton Drejtoria e Shërbimeve Publike.

4. Tërheqja – bartja e automjeteve bëhet me urdhër dhe nën kontrollin e Policisë dhe të Inspektoratit të Komunikacionit, duke konstatuar gjendjen e automjetit para se të lëshohet urdhëresa për tërheqje.

5. Operatori i transportit me “merimangë” do të caktohet përmes tenderit të shpallur për kryerjen e shërbimeve të transportit me “merimangë” në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara.

Neni 57

1. Komuna do të lidhë kontratë me operatorin e transportit me “merimangë” (më poshtë i quajtur OPERATORI –fituesin e tenderit me të cilin më për së afërmi do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese).

2.Kontrata nga paragrafi paraprak lidhet për kohë të pacaktuar por jo më gjatë se tre (3) vjet.

3.Automjeti që nuk tërhiqet nga vendi i caktuar në afatin prej 6 muajsh nga dita e vendosjes në atë vend kalon në pronësi të Komunës.

4.Komuna mund ti shes automjetet nga paragrafi paraprak përmes ankandit publik.

5.Mjetet nga shitja e automjeteve inkasohen në buxhetin e Komunës nëse i ruan ato në parkingun e vet.

6.Nëse vendparkimi për qëndrimin e automjeteve i është dhënë ndonjë operatori privat, 30 përqind e mjeteve të inkasuara nga shitja e veturave i kalojnë komunës, ndërsa 70 përqind i kalojnë operatorit.

7.Vlera e automjeteve përcaktohet përmes komisionit të formuar nga Kryetari i Komunës.

Neni 58

1.Në momentin e tërheqjes – marrjes së automjetit nga operatori, përveç dëshmisë së pagesave, operatori duhet të kërkojë dëshminë e pronësisë ose dëshminë se ka qenë duke drejtuar atë para se të bllokohej automjeti, përkatësisht para se të jetë tërhequr në vendin e caktuar për këtë.

2. Operatori nuk duhet të shtyjë lëshimin e automjetit kur pronari ose drejtuesi i automjetit jep dëshminë e kërkuar sipas paragrafit paraprak dhe bën pagesën e taksës sipas dispozitave të kësaj rregullore.

Kushtet për shërbimin e transportit për “Merimangë”

Neni 59

Shërbimi i transportit për “merimangë” duhet të jetë i licencuar.

1. Kushtet për licencim janë:

- a) Të jetë regjistruar për ushtrimin e shërbimit për merimangë;
- b) Të ketë së paku dy (2) automjete për bartje të automjeteve;
- c) Të ketë së paku njëzetë (20) bllokues rrotash me ngjyrë të verdhë;
- d) Të ketë sistem funksional të komunikimit;
- e) Të sigurojë shërbimin 24/7 në javë;
- f) Të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë;
- g) Të ketë vendparkimin për vendosjen e automjeteve (të dëshmuar me listë poseduese ose kontratë mbi shfrytëzimin).
- h) Të ketë zyre administrative (me seli në Komunën e Kaçanikut).
- i) Të mos ketë ndalesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 60

1. Kushtet për automjetet bartëse:

- a) Të jenë të regjistruara në Komunën e Kaçanikut.
- b) Të jenë të dedikuara posaçërisht për bartjen e automjeteve,
- c) Të jenë teknikisht në rregull në çdo kohë, si dhe të kenë kontroll teknike periodike për 6 (gjashtë) muaj,
- d) Të vënë firmën, respektivisht emërtimin e transportuesit, në pjesën anësore,
- e) Të kenë pajisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe paisjet rezervë të automjetit,
- f) Të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet
- g) Të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.
- h) Emri i operatorit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në certifikatën e regjistrimit të automjetit (CRA) dhe në dokumentet tjera përcjellëse të mjetit.

Neni 61

1. Kushtet për drejtuesit e automjeteve:

- a) Të jenë punëtorë të regjistruar te operatori;
- b) Të kenë patent shoferin e kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit gjegjë;
- c) Të ketë ndihmësin për kryerjen e bartjes;
- d) Gjatë transportit, operatori është i detyruar që në mjet të ketë edhe këto dokumente: Licencën, flete urdhëresën e rrugës dhe certifikatën e regjistrimit të automjetit (CRA);
- e) Shefori duhet të jetë i paisur me certifikat të mjekut të vlefshme 5 vite.

Neni 62

1. Pagesa për lirimin (rimarrjen e automjetit)

- 1.1. Operatori si kusht për lirimin e automjetit, pronarin, drejtuesin e automjetit do t'ja ngarkojë me pagesë si më poshtë:
- 1.2. Për tërheqjen e autoveturave brenda qytetit do të paguhet sipas tarifës së përcaktuar me akte ligjore në fuqi.
- 1.3. Për tërheqjen e kombibusave dhe xhipave brenda qytetit do të paguhet sipas tarifës me akte ligjore në fuqi.

1.4. Për tërheqjen e kamionëve dhe autobusave brenda qytetit do të paguhet sipas tarifës me akte ligjore në fuqi.

1.5. Për tërheqjen e automjeteve nga zonat jashtë qytetit përveç çmimeve të caktuara duhet të paguhet operatori në bazë të akte ligjore në fuqi.

1.6. Në rast se pronari përkatësisht drejtuesi i automjetit largon automjetin para se të arrijë automjeti për bartje paguan gjysmën e tarifës të caktuar.

1.7. Nëse automjeti nuk tërhiqet brenda 48 orëve pas kësaj kohe për çdo 24 orë do të paguhet sipas tarifës së caktuar nga Komuna.

1.8. Të gjitha pagesat nga paragrafi paraprak do të bëhen përmes bankës së caktuar, si të hyrat e drejtoratit.

1.9. Taksat e shërbimeve do t'i vërtetojë Drejtoria e Financave.

2. Për secilën pagesë do të lëshohet fatura e cila do të jetë rendore dhe do të përmbajë këto të dhëna:

2.1. markën dhe modelin e automjeteve

2.2. numrin e targave

2.3. emrin e plotë, adresën dhe numrin e letërnjoftimit të pronarit

2.4. emrin e plotë dhe numrin e letërnjoftimit të personit të cilit i lirohet automjeti

2.5. datën e bllokimit të automjetit

2.6. datën e lirimit dhe vendin e lirimit (në vendqëndrimin e automjeteve apo në vendin ku është bllokuar).

Neni 63

1. Drejtoria here pas here do t'i kontrollojë të dhënat e operatorit lidhur me shërbimet e bëra, pajisjet dhe vendin për parkim.

2. Drejtoria ka të drejtën e kontrollimit të të dhënave edhe pas skadimit apo të ndërprerjes së kontratës dhe atë në periudhën prej pesë viteve.

3. Sipas kërkesës së drejtorisë operatori obligohet që të sjellë faturat e ruajtura për arkivim në drejtorat.

4. Operatori i dorëzon llogarinë mujore të punuar sipas Rregullores për Taksa dhe Tarifa të Komunës.

5. Operatori në përputhshmëri me Rregulloren për Taksa dhe Tarifa do të bëjë pagesat mujore në xhirollogarinë e caktuar nga Komuna.

Neni 64

Në rast të shkeljes së ndonjëres nga dispozitat e kësaj rregulloreje, drejtorati mban të drejtën e shpërbërjes së kontratës për çka edhe do të njoftohet operatori me kohë.

Neni 65

Transporti rrugor i mallrave

1. Transporti rrugor i mallrave (më poshtë i quajtur: transporti i mallrave) kryhet si:

1.1. Transporti i mallrave për nevoja personale, dhe

1.2. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë.

2. Gjatë transportit të mallrave, operatori në automjet duhet t'i ketë këto dokumente:

2.1. licencën;

2.2. fleturdhëresë;

2.3. shoferit të kenë patent shoferin e kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit gjegjës;

2.4. shoferi duhet të jetë i paisur me certifikat të mjekut të vlefshme 5 vite;

- 2.5. shoferi të jenë punëtorë i regjistruar te operatori;
- 2.6. çertifikatën e regjistrimit të automjetit (CRA), me regjistrim të mjetit, si dhe emri i operatorit - firmes duhet të jetë i njëjtë i shënuar në (CRA) dhe në dokumentet tjera përcjellëse, si dhe paisjet rezervë të automjetit;
- 2.7. automjeti të jenë teknikisht në rregull në çdo kohë, si dhe të kenë kontroll teknike periodike për 6 (gjashtë) muaj,

Neni 66

Kushtet dhe kriteret për licencim të operatorëve të transportit rrugor të mallrave

1. Për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të mallrave, operatori duhet të plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të jetë i regjistruar në Kosovë (çertifikata e regjistrimit të biznesi);
 - 1.2. Selia e kompanisë të jetë në territorin e Komunës së Kaçanikut;
 - 1.3. Të ketë reputacion të mirë;
 - 1.4. Të mos ketë pengesa juridike për zhvillim të veprimtarisë;
 - 1.5. Të ketë automjetet e transportit në gjendje të mirë teknike-eksploatauese.
 - 1.6. Listën më të dhënat e mjeteve transportues,
 - 1.7. Shefori duhet të jetë i paisur me çertifikat të mjekut të vlefshme 5 vite.
2. Licencat për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të mallrave jepen kundrejt pagesës që parasheh Rregullorja e Komunës për Taksa dhe Tarifa Komunale.

Neni 67

Transporti i mallrave për nevoja vetanake

1. Ndalohet marrja me transport për nevoja vetanake, pa qenë i regjistruar si transportues për këtë.
2. Dispozita e pikës paraprake nuk do të zbatohet mbi mbajtësin e licencës për transport të mallrave me qira.

Neni 68

1. Emri dhe natyra e biznesit duhet të deklarohen kur të regjistrohet veprimtaria e transportit të mallrave për nevoja vetanake.
2. Regjistrimi nuk do të jetë i efektshëm derisa aplikuesi të tregoj se transporti i mallrave për të cilin është kërkuar regjistrimi, mund të emërohet si transport i mallrave për nevoja vetanake.

Neni 69

1. Me rastin e kryerjes së transportit për nevoja vetanake me automjet mbi 3,5 deri në 12 tonelata të një mase më të madhe të lejuar, në automjet duhet të ketë:
 - 1.1 fletëngarkesën dhe
 - 1.2 dëshminë nga e cila mund të vërtetohet se është fjala për transportin e mallrave për nevoja vetanake.

Neni 70

Transporti i mallrave me qira dhe pagesë

1. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë (për palë të tretë) kryhet në bazë të marrëveshjes me shkrim ose me gojë në mes të dërguesit dhe marrësit të mallit i cili kontraktin transportin e mallrave.
2. Gjatë transportit të mallrave me qira dhe pagesë, operatori i transportit në automjet duhet të ketë:
 - 2.1. fletëngarkesën dhe

2.2 kontratën në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.

3. Mjetet me të cilat kryhet ky lloj transporti duhet të ngasin shoferët të punësuar tek personi juridik apo fizik ose vet personi fizik

4. Mjetet duhet të jenë në pronësi të personit fizik apo juridik dhe të pajisur me certifikatë të mjetit.

Neni 71

Mbikqyrja dhe kontrolli

1. Mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Inspeksioni i komunikacionit rrugor dhe policia e Kosovës.

2. Operatori i transportit rrugor është i detyruar t'i paraqes inspektorit tërë dokumentacionin e kërkuar dhe t'i krijoj atij të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave sipas kësaj rregulloreje dhe ligjeve në fuqi.

3. Inspeksioni i komunikacionit rrugor është i autorizuar:

3.1 Të bëjë kontrollin e operatorëve të transportit rrugor se a janë duke ushtruar veprimtarinë e vet në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe Ligjeve në fuqi,

3.2 Të urdhëroj mënjanimin e lëshimeve dhe mangësive në aspektin e plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore dhe Ligjeve në fuqi, për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave,

3.3 Të përjashtoj nga qarkullimi automjetin me të cilin kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj Rregulloreje të caktoj vendparkimin, të marr lejen e qarkullimit dhe targat në kohëzgjatje prej 48 orësh.

4. Nëse të njëjtit operator të transportit i shqiptohet masa e dënimit për herë të dytë, për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 3 pika 3.3 të këtij neni, automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi, në kohëzgjatje deri në 5 ditë.

5. Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi, i merret shenja "TAXI" - "RADIO TAXI", targat e regjistrimit, certifikata e regjistrimit të automjetit.

6. Me kalimin e afatit të shqiptimit të dënimit, nga paragrafi 3 pika 3.3 dhe paragrafi 4 i këtij neni, inspektori ia kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra, qoftë vet apo përmes organit i cili ka lëshuar këto.

Neni 72

1. Inspektori i komunikacionit rrugor dhe policia e Kosovës, në kuadër të autorizimeve të tyre, shqipton gjoba mandatore dhe bën fletparaqitje për iniciimin e procedurës kundërvajtëse pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, për kundërvajtje kundër atyre të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe ligjeve në fuqi.

2. Inspektori i komunikacionit rrugor, bën kërkesa, njoftime, urdhëresa dhe vendime në funksion të zbatimit të kësaj rregulloreje si dhe inicon procedurë përmbartimore.

Neni 73

Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet në shpenzime të mbajtësit të licencës, në vende të caktuara për këto raste.

Neni 74

1. Kundër vendimit të inspektorit komunal të komunikacionit rrugor, mund t'i ushtrohet ankesa në komisionin komunal të ankesave, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

2. Ankesa dërgohet përmes organit komunal kompetent.
3. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Neni 75 **Dispozitat ndëshkimore**

1. Për kundërvajtje me gjobë prej 100 € deri në 1000 €, do të dënohet operatori transportues, përkatësisht personi juridik apo fizik për kundërvajtje, në qoftë se:
 - 1.1 Ushtron veprimtarinë e transportit publik urban dhe urbano – periferik pa licencë – leje pune (neni 8),
 - 1.2 ushtron veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve në kundërshtim me nenin 9, dhe 10,
 - 1.3 Vepron në kundërshtim me nenin 11, nenin 17 paragr. 6, neni 18.

Neni 76

1. Për kundërvajtje me gjobë prej 500 € deri në 1000 €, do të dënohet operatori transportues, përkatësisht personi juridik apo fizik për kundërvajtje, në qoftë se:
 - 1.1. Vepron në kundërshtim me nenin 71.

Neni 77

1. Me gjobë prej 100 € deri në 800 € do të dënohet operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik dhe fizik, në qoftë se:
 - 1.1. Vepron në kundërshtim me nenin 7, nenin 12, 16, 17, 18 si dhe nenet 20, 21, 22, 23, 24.

Neni 78

Me gjobë prej 50 € deri në 300 € do të dënohet për kundërvajtje nëse veprohet në kundërshtim me dispozitat e nenit 25 pika 1.2, paragrafi 2), pika 2.2; 2.3; 2.4; paragrafet 4, 5, 6, 7, 8 dhe nenet 27, 28, 36, 37, neni 38 paragrafi 1) pikat 1.3; 1.4; 1.5; 1.6; 1.9; paragrafi 2) si dhe nenet 42, 47, 49, 50, 51, 52, 53.

Neni 79

1. Me gjobë prej 100 € deri në 200 € do të dënohet për kundërvajtje operatori i transportit:
 - 1.1 Vepron në kundërshtim me neni 29, 30, 32, 39, 46, 55.
2. Për kundërvajtje, nga pika 1 e këtij neni, do të dënohet edhe personi fizik me gjobë prej 50 € deri në 100 €.

Neni 80

Me gjobë prej 100 € deri në 300 € do të dënohet për kundërvajtje nëse veprohet në kundërshtim me dispozitat e nenit 26, 40, 48, 54, 63, 67, 68.

Neni 81

Me gjobë prej 100 € deri në 400 € do të dënohet për kundërvajtje nëse veprohet në kundërshtim me dispozitat e nenet 33, 34, 35, 38 paragrafi 1) pikat 1.1; 1.2; 1.7; 1.8; 1.10; 1.11; 1.12; 1.13 si dhe nenet 64, 65, 69, 70.

Neni 82

1. Me gjobë prej 100 € deri në 500 € do të dënohet operatori i transportit:

1.1 nëse veprohet në kundërshtim me dispozitat e nenit 25 pika 1.1; 1.3; 1.4; paragrafi 2) pika 2.1; 2.5, paragrafi 3), si dhe nenet 41, 43, 44, 45, 56, 57, 60, 61.

2. Për kundërvajtje, nga pika 1 e këtij neni, do të dënohet edhe personi fizik me gjobë prej 50 deri në 100 €.

Neni 83

1. Dënimet mandatore për kundërvajtje në shumë deri në 1000(njëmijë) € i shqipton Inspektori i Komunikacionit.

2. Në rast se subjekti i mbikëqyrur, nuk bën ekzekutimin e gjobës brenda afatit të dhënë me aktvendim, inspektori mund të inicioj procedurë kundërvajtëse në gjyketën kompetente ose të bëj iniciimin e procedurës përmbartimore, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur aktvendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Neni 84

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Obligohen operatorët e transportit rrugor, që në afat prej 6 muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të bëjnë harmonizimin e akteve të tyre me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 85

Nëse operatori i transportit, përkatësisht personi fizik apo juridik bën përsëritje të kundërvajtjes së njejtë, atëherë përpos dënimit me gjobë, do të shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor në kohëzgjatje prej 6 deri 12 muaj.

Neni 86

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja 01Nr.07-344-32032/14 e datës 31.10.2014 Për Transport Rrugor në Territorin e Komunës së Kaçanikut.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, revokohen të gjitha rendet ekzistuese të udhëtimit.

Neni 87

Për të gjitha rastet që nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohet ligji për transport rrugor.

Neni 88

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në protokollin e MAPL-së, përkatësisht 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e komunës.



Komuna e Kaçanikut

Date	16-06-23	
Mj Org.	WASHAC OF HCB	
Membre		

Opština Kacanik

Në mbështetje të nenëve 12, par. 2, 68, par. 4 të Ligjit Nr. 034/2040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28.06.2008), nën 42 par. 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, si dhe Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut nxjerrë këtë:

RRREGULLORE PËR TRANSPARENCË E KOMUNËS SË

KAÇANIKUT

KAPITULI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Nemi I

Qeillirni

1. Kjo Rregulllore përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të komunës, drejtorive, kuvendit, trupave të kuvendit si dhe mekanizmave të tjerë ligjor, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshijes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse

Nenì 2

Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha organet e komunës që ushtrojnë autorizime publike sipas ligjit.

Neni 3

Pärkufüzimet

UREDBU O TRANSPARETNOSTI OPŠTINE KACANIK

POGLAVLJE I. OPŠTE ODREDBE

Član 1.

Syrha

1. Ovom Uredbom utvrđena su pravila kojima se obezbeđuje transparentnost rada organa opštine, gradonačelnika opštine, uprava, skupštine, organa skupštine kao i drugi pravni mehanizmi, kao i pravila, načela i oblici uključivanja građana, civilnog društva i interesnih grupa u procesima donošenja odluka.

Član 2.

Delokrug

1. Odredbe ove uredbe sprovode se za sve opštinske organe koji vrše javna ovlašćenja prema zakonu.

Clan 3.

Definicije

1. Shprehjet dhe shkurtetat e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kupime:

1.1. **Transparencë** - Transparenca është veprimtari e hapur e organeve të komunës që siguron publikim, informim, qasje në dokumente publike dhe përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe punës së organeve komunale.

1.2. **Akte normative të komunës** – nënkupton akte normative të karakterit të përgjithshëm të tilla si: Statuti i Komunës, rregulloret e Kuvendit të Komunës, planet hapësinore në nivel lokal, aktet të tjera që parashihen me ligjet sektoriale.

1.3. **Mogartdhënie** – nënkupton procesin ku institucionet komunale japin përgjegjësi për ushtrimin e kompetencave të tyre

1.4. **Vendim** – nënkupton akt normativ që nxirret nga organi kompetent i komunës sipas dispozitave ligjore me të cilin vendoset për çështje të caktuar.

1.5. **Konsultim publik** – nënkupton përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin konsultues para vendimmarrjes

1.6. **Buxhetim me pjesëmarrje** - nënkupton një proces demokratik dhe gjithpërfshirës, i cili u mundëson qytetarëve të kenë rol të drejtpërdrejtë vendimmarrës, për të planifikuar shpërndarjen e buxhetit të komunës, sipas prioritetëve të qytetarëve.

1.7. **Dëgjimi buxhetor** – nënkupton konsultimet publike të mbajtura nga komunat në procesin e hartimit të buxhetit dhe projeksioneve afatmesme buxhetore.

1. Izrazi i skraçenice koji se koriste u ovoj uredbi imaju sledeća značenja:

1.1. **Transparentnost** - je otvorena aktivnost opštinskih organa koja obezbeđuje objavljivanje, informisanje, pristup javnim dokumentima i uključivanje građana u proces donošenja odluka i rad opštinskih organa.

1.2. **Normativni akti opštine** –podrazumevaju normativni akti opšteg karaktera kao što su: Statut opštine, pravilnici Skupštine opštine, prostorni planovi na lokalnom nivou, drugi akti predviđeni sektorskim zakonima.

1.3. **Odgovornost** – podrazumeva postupak kada opštinske institucije polazu odgovornost za obavljanje svojih nadležnosti

1.4. **Odluka** –podrazumeva normativni akt koji donosi nadležni organ opštine prema zakonskim odredbama kojim se odlučuje o određenom pitanju.

1.5. **Javna konsultacija** –podrazumeva uključenosť građana i zainteresovanih strana u proces konsultacija pre donošenja odluke

1.6. **Budžetiranje uz učesće** – podrazumeva demokratski i sveobuhvatan proces, koji omogućava građanima da imaju neposrednu ulogu u odlučivanju, da planiraju raspodelu budžeta opštine, prema prioritetima građana.

1.7. **Budžetska rasprava** – podrazumeva javne konsultacije koje održavaju opštine u procesu izrade budžeta i srednjoročnih projekata budžeta.

1.8. Dokument publik – nënkupton çdo akt, fakt apo informata në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik. 1.9. Grupi punues – është ekipi përgjegjës për hartimin e projekt propozimit, i caktuar nga organi kompetent i komunës. 1.10. Live meeting office communicator apo transmetime direkte në youtube apo rrjetet sociale – nënkupton aplikacione përmes së cilave mundësohet komunikimi në distancë. 1.11. Sesion i teleprezencës - nënkupton akceptimin i e - mailit të dërguar nga komunitat për qasje në formatin përkatës. - 1.12. Sistemi operativ MS Windows 7nënkupton sistem operativ i teknologjisë së Microsoftit- 1.13. MAPL – nënkupton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. - 1.14. Monitorim i kuventit të komunës përmes teleprezencës - nënkupton të drejtën dhe mundësinë e MAPL-së që përmes pajisjeve të teleprezencës të siguroj mbikëqyrjen e mbarrëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve të komunave pa praninë fizike të zyrtarëve në komunë. 1.15. Pajisje për transmetim dhe monitorim të mbledhjeve - nënkupton kamerë e përshtatshme për teleprezencë që mundëson transmetimin e mbledhjeve me pamje të kompletuar përmes video dhe audio përmbytjes; 1.16. Palë e interesuar – nënkupton çdo person fizik dhe juridik, organizatë e shoqërisë civile, grupe të ndryshme të interesit, si dhe	1.8.Javni dokument – podrazumeva svaku akt, činjenicu ili informaciju u elektronskom ili zvučnom obliku, štampanom obliku, vizuelnim ili audiovizuelnim snimcima koje proizvodi ili drži javna institucija. 1.9. Radna grupa – je odgovorna ekipa za izradu predlog projekta koji je određen od strane nadležnog organa opštine. 1.10. Kancelarijski komunikator za sastanke uživo ili prenosi uživo na youtube ili društvenim mrežama –podrazumeva aplikacije preko kojih je omogućena daljinska komunikacija. 1.11. Sesija teleprisustva –podrazumeva prihvatanje e-pošte koju su opštine poslate za pristup u relevantnom obliku. 1.12. Operativni sistem MS Windows- podrazumeva operativni sistem Microsoft tehnologije 1.13.MALS – podrazumeva Ministarstvo administracije lokalne samouprave. - 1.14.Praćenje Skupštine opštine putem teleprisustva – podrazumeva pravo i mogućnost MALS-a da putem teleprisustva obezbedi praćenje održavanja sednica skupština opština bez fizičkog prisustva službenika u opštini. 1.15.Uredaji za prenos i praćenje sednica - podrazumeva kameru pogodnu za teleprisustvo koja omogućava prenos sednica u potpunom prikazu putem video i audio sadržaja; 1.16.Zainteresovana strana –podrazumeva svako fizičko i pravno lice, organizaciju civilnog društva, različite interesne grupe, kao i
---	--

subjekte të tjera që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në procesin e vendimmarrjes.

1.17. Projekt-propozim apo Projekt-akt - nënkupton të gjitha dokumentet dhe aktet normative të cilat janë në proces të hartimit dhe që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik para aprovimit të tyre.

1.18. Propozues i akteve nënligjore të komunës dhe politikave lokale - nënkupton: kryetarin e komunës, drejtoritë komunale, kryesuesin e kuvendit të komunës, komitetet e kuvendit të komunës, pesëmbëdhjetë për qind (15%) e qytetarëve të komunës përkatëse me të drejtë vote.

1.19. Politika lokale - i referohet, planeve, dokumenteve strategjike, buxhetit të komunës, Korniza Afatmesme Buxhetore, planeve hapësinore në nivel lokal, akteve komunale, strategjive të zhvillimit në kuadër të fushave specifike zhvillimore, udhëzuesve dhe veprimeve të cilat ndikojnë në vendimmarrjen komunale, planeve të punës së kuvendit dhe ekzekutivit, si dhe programeve të tjera të rëndësishme me interes publik.

1.20. Pronë komunale - nënkupton pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruar dhe në posedim të komunës.

1.16. Standardet minimale të konsultimit - janë rregulla procedurale minimale që kanë për qëllim zhvillimin e konsultimeve publike efektive gjatë procesit të hartimit të politikave dhe akteve normative nga komunat, me përfshirje të palëve të interesuara dhe qytetarëve, përveç nëse parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi.

1.21. Takim publik me qytetar - nënkupton takime të rregullta publike të karakterit informues me qytetarë sipas nenit 68 paragraf 1 të Ligjit Nr.03L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

duke subjekte koji su pogođeni ili su zainteresovani da neposredno ili posredno učiu na proces donošenja odluka.

1.17. Predlog-projekt ili projektni-akt - podrazumeva sve dokumente i normative akte koji su u postupku izrade i koji su predmet postupka javnih konsultacija pre njihovog usvajanja.

1.18. Predlaagač podzakonskih akata opštine i lokalnih politika - podrazumeva: gradonačelnika opštine, opštinske uprave, predsedavajućeg Skupštine opštine, odbore Skupštine opštine, petnaest (15%) građana relevantne opštine sa pravom glasa.

1.19. Lokalne politike odnosi se na planove, strateške dokumente, opštinski budžet, srednjoročni budžetski okvir, prostorne planove na lokalnom nivou, opštinske akte, strategije razvoja u okviru određenih razvojnih oblasti, smernice i radnje koje učiu na donošenje opštinskih odluka, planove rada Skupštine i izvršne vlast, kao i druge značajne programe od javnog interesa.

1.20. Opštinska imovina - podrazumeva nepokretnu ili pokretnu imovinu koja je upisana i u vlasništvo opštine.

1.16. Minimalni standardi konsultacije - su minimalna proceduralna pravila koja imaju za cilj da razviju efikasne javne konsultacije tokom procesa izrade politika i normativnih akata od strane opština, uz uključivanje zainteresovanih strana i građana, osim ako je drugačije predviđeno zakonodavstvom na snazi.

1.21. Javni skupovi sa građanima - podrazumeva redovne sastanke javnog informativnog karaktera sa građanima prema članu 68, stav 1, Zakona br.03L-040 o lokalnoj samoupravi

1.22. Zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike - nënkupton zyrtar administrativ në kuadër të institucionit publik, i caktuar për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuarra për qasje në dokumente publike, për kryerjen e shqyrtimit fillestar të këtyre kërkesave, për ruajtjen dhe mbajtjen e evidencave të këtyre kërkesave dhe për raportimin rreth këtyre kërkesave.

1.23. Zyrtari për Monitorim - nënkupton zyrtarin përgjegjës për monitorim të komunave në MAPL.

2. Shprehjet e përdorura në shumës e kanë të njëjtin kuptim edhe në njëjtës, dhe shprehjet e përdorura në një gjini e kanë kuptimin e njëjtë edhe për gjininë tjetër.

KAPITULLI II TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 4

Transparenca në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteleve

1. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteleve janë publike, përveç rasteve kur kufizimi është përcaktuar me ligj.
2. Kryesuesi i Kuvendit ose kryesuesi i komiteit, përmes shërbimit të administratës ofron kushtet, mjetet, materialet dhe vendin e caktuar për të garantuar pjesëmarrjen e publikut.
3. Kryesuesi i Kuvendit ose Komitetit, përmes Njesisë për Komunikim Publik obligohet të publikoj në ueb faqen zyrtare të gjitha aktet dhe vendimet e Kuvendit dhe trupave të tjera.

Neni 5

1.22. Službenik odgovoran za pristup javnim dokumentima - podrazumeva administrativnog službenika u javnoj instituciji, koji je određen da prima i registruje zahteve za pristup javnim dokumentima, da vrši početno razmatranje ovih zahteva, da čuva i održava evidenciju o ovim zahtevima i da izveštava o ovim zahtevima.

1.23. Službenik za praćenje (monitorisanje) – podrazumeva službenika odgovornog za praćenje opština u MAPL-u.

2. Izrazi koji se koriste u množini imaju isto značenje u jednini, i izrazi koji se koriste u jednom rodu imaju isto značenje u drugom rodu.

POGLAVLJE II TRANSPARENTNOST RADA SKUPŠTINE OPŠTINE

Član 4.

Transparentnost na sednicima i odborima Skupštine opštine

1. Svi sastanci Skupštine opštine i odbora su javni, osim u slučajevima kada je ograničenje utvrđeno zakonom.
2. Predsedavajući Skupštine opštine ili predsedavajući odbora, putem administrativne službe, obezbeđuje uslove, sredstva, materijale i određeno mesto za garantovanje učešća javnosti.
3. Predsedavajući Skupštine ili odbora, putem Jedinice za javno komuniciranje, dužan je da na službenoj internet stranici objavljuje sve akte i odluke Skupštine i drugih organa.

Član 5.

Informimi për mbledhjet e kuvendit dhe komitetete	Informisanje o sastancima Skupštine i odbora
1. Kryesuesi i Kuvendit ose Komitetit, përmes Njësise për Komunikim me Publikun, publikon njoftimin për mbledhje së paku 7 (shtatë) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, 3 (tre) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, si dhe brenda ditës për mbledhjet urgjente. 2. Njoftimi për mbledhje nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet përmes: 2.1. Ueb-faqes zyrtare të komunës dhe tabelat e shpalljeve. 2.2. Me qëllim të arritjes së audiencës komuna promovon agjendën në rrjetet sociale, dhe forma alternative të komunikimit me publikun. 3. Njoftimi publik sipas paragrafi 2 të këtij neni përmban: 3.1. Datën, kohën vendin, rendin e ditës, materialet e mbledhjes për mbajtje të takimit. 3.2. Komuna publikon edhe të dhëna të tjera të cilat përcaktohen me Statut dhe Rregullore të Punës së Komunës. 4. Kryesuesi i Kuvendit me shkresë zyrtare me informacionet sipas paragrafi 1 dhe 3 të këtij neni e njofton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për mbledhje të kuvendit. 5. Komuna përveç informimit për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteteve vazhdimisht duhet ti njoftojë që qytetarët kanë të drejtë të jenë pjesë e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.	1. Predsedavajući Skupštine ili odbora, putem Jedinice za javno komuniciranje, objavljuje obaveštenje o sednici najmanje 7 (sedam) radnih dana pre redovnih sednica, 3 (tri) radna dana pre vanrednih sednica, kao i u toku dana za hitne sednice. 2. Obaveštenje za sednice iz stava 1 ovog člana se vrši kroz: 2.1. službeni web stranicu opštine i na tabelama za oglas. 2.2. u cilju postizanja audiencije (publike), opština promovise dnevni red na službenim mrežama i alternativnim oblicima komuniciranja sa javnošću. 3. Javni oglas prema stavu 2 ovog člana sadrži: 3.1. datum, vreme, dnevni red i sadržani materijal za održavanje sednice. 3.2. Opština objavljuje i druge podatke koje se određuju Statutom i Pravilnikom o radu opštine. 4. Predsedavajući Skupštine putem službenog pisma i prema stavu 1 i 3 ovog člana obaveštava Ministarstvo administracije lokalne samouprave za sednicu Skupštine. 5. Opština, pored obaveštavanja o održavanju sednica Skupštine i odbora, mora kontinuirano da najavljuje da građani imaju pravo da budu deo sednica Skupštine opštine.

Neni 6

Monitorimi elektronik i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave

1. Organet e Komunës janë të obliguara të sigurojnë qasje aktive në përdorimin e sistemit të teleprezencës, me qëllim të krijimit të kushteve

Çlan 6.

Elektronsko praćenje sednica skupština opština

1. Opštinski organi su dužni da obezbede aktivan pristup korišćenju sistema teleprisustva, kako bi se stvorili uslovi za praćenje i ocenjivanje procesa

për monitorim dhe vlerësim të proceseve për mekanizmat monitoruese të MAPL-së, palëve të interesuara dhe institucioneve tjera në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, përmes stafit të autorizuar të komunës. 2. Komuna mund të përdorë aplikacione si live meeting office communicator apo transmetime direkte në you-tube apo rrjetet sociale për të garantuar publicitet, si dhe çfarëdo platforme të ligjshme për të transmetuar drejtpërdrejtë ngjarjen. 3. Kryesuesi, anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryetari, dhe pjesëmarrësit e tjerë janë të obliguar që gjatë rrjedhës së punimeve të Kuvendit të përdorin mikrofonin i cili mundëson lidhjen me sistemin e zëritit dhe transmetimin e audio – përmbajtjes në sistemin.	za mehanizme praçenja MAL-S-a, zainteresovanih strana i drugih institucija na sednicama Skupštine opštine, kroz ovlašćeno osoblje opštine. 2. Opština može da koristi aplikacije kao što je komunikator za direktne sednice ili prenos na you-tube ili društvenim mrežama da garantuje publicitet, kao i bilo koju pravnu platformu za prenos direktnih događaja. 3. Predsedavajući, odbornici Skupštine opštine, gradonačelnik i drugi učesnici su dužni da u toku rada Skupštine koriste mikrofon koji omogućava povezivanje na uzvucenje i prenos audio sadržaja u sistemu.
Neni 7 Përdorimi dhe mirëmbajtja e sistemit të Teleprezencës 1. Komuna është e obliguar të sigurojë kushtet për funksionimin e teleprezencës gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. 2. Sekretaria e Kuvendit të Komunës është përgjegjëse për menaxhimin e llogarisë së formës vc.komuna@rks-gov.net, gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. 3. Zyrtari përgjegjës për monitorim të komunave ka të drejtën e qasjes në sistemin në çdo kohë kur mbahen mbledhjet e Kuvendeve të Komunave. 4. Komuna është e obliguar të caktoj një pikë kontaktuese për komunikim me Zyrtarin Monitorues të Ministrisë. 5. Zyrtari përgjegjës i komunës duhet të vendos lidhjen e teleprezencës, 15 minuta para fillimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, përmes pranimit të e-mailit ose linjave të tjera zyrtare nga Zyrtari Monitorues i Ministrisë.	Član 7. Upotreba i održavanje sistema teleprisustva 1. Opština je dužna da obezbedi uslove za rad teleprisustva tokom održavanja sednica Skupštine opštine. 2. Sekretarijat Skupštine opštine odgovoran je za vođenje računa obrasca vc.komuna@rks-gov.net, tokom održavanja sednica Skupštine opštine. 3. Službenik odgovoran za praćenje opština ima pravo pristupa sistemu u bilo koje vreme kada se održavaju sednice skupština opština. 4. Opština je dužna da odredi tačku za kontakt za komunikaciju sa službenikom za praćenje iz ministarstva. 5. Odgovorni službenik opštine mora uspostaviti vezu za teleprisustvo, 15 minuta pre početka sednice Skupštine opštine, putem e-maila ili drugih zvaničnih linija od službenika za praćenje iz ministarstva.

6. Në vendin e mbajtes së mbledhjes, organet e komunës duhet të sigurojnë prezencën dhe funksionimin e pajisjeve të teleprezencës. 7. Zyrtari përgjegjës për informim në Komunë, obligohet të siguroj lidhjen e transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjes së Kuvendit të Komunës në sistemin e integruar të faqes zyrtare të Komunës, për t'i mundësuar qasjen qytetarëve dhe palëve të interesuara për përcjelljen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës. 8. Sekretaria e Kuvendit të Komunës obligohet të arkivoj videot dhe audiot nga mbledhjet e mbajtura të Kuvendeve të Komunave në arkivën elektronike të komunës. 9. Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës janë përgjegjës për të siguruar kushtet për Monitorimin elektronik të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave.	6. Në mësht shtstankk opštinski organi moraju obezbediti prisustvo i rad opreme za teleprisustvo. 7. Službenik nadležan za informisanje u opštini dužan je da obezbedi povezivanje direktnog prenosa sednice Skupštine opštine u integrirani sistem zvanične web stranice opštine, da omogući pristup građanima i zainteresovanim licima da prate sednici Skupštine opštine. 8. Sekretarijat Skupštine opštine je dužan da video i audio zapise sa održanih sednica skupština opština arhivira u elektronskoj arhivi opštine. 9. Gradonačelnik opštine i predsedavajući Skupštine opštine su odgovorni za obezbeđivanje uslova za elektronsko praćenje sednica skupština opština.
Neni 8 Njoftimi për mbledhjet e Kuvendeve të Komunave për monitorim elektronik 1. Komuna obligohet të dërgoj në Ministri ftesën dhe materialet shesë të mbledhjes së Kuvendit në formë elektronike të paktën shtatë (7) ditë pune para mbajtes së mbledhjeve të rregullta, si dhe tri (3) ditë pune para mbajtes së mbledhjeve të jashtëzakonshme. 2. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, rendin e ditës, kohën e saktë të mbledhjes, materialet e mbledhjes, ashtu siç është paracaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.	Član 8. Obaveštenje za sednice Skupština opština za elektronsko praćenje 1. Opština je dužna da poziv i dodatni materijal za sednicu Skupštine uputi ministarstvu u elektronskom obliku najmanje sedam (7) radnih dana pre održavanja redovnih sednica, kao i tri (3) radna dana pre održavanja vanrednih sednica. 2. Obaveštenje mora da sadrži mesto, datum, dnevni red, tačno vreme održavanja sednice, materijale za sednicu, kako je propisano Zakonom o lokalnoj samoupravi.
Neni 9 Kufizimi i qasjes në mbledhjet e kuvendit apo komitetit	Član 9. Ograničenje na sednicima Skupštine opštine ili odbora

1. Mbledhjet e Kuvendi apo komiteteve mund të jenë të mbyllura pjesërisht apo tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara me legjislaacionin në fuqi.

2. Kuvendi i Komunës dhe komitetet e kuvendit me vendim të arsyetuar shpallin mbledhjet e plotësisht apo pjesërisht të mbyllura për publikun.

KAPITULLI III

TRANSPARENCA E EKZEKUTIVIT

Neni 10

Transparenca e ekzekutivit

1. Kryetari i komunës ofron transparencë për procesin vendimmarrës të tij, drejtorive dhe administratës.

2. Kryetari i komunës është përgjegjës për zbatimin e legjislaacionit në publikim të akteve të ekzekutivit, dhe dokumenteve zyrtare në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtën e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente Publike.

3. Kryetari i komunës raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës.

4. Kryetari i komunës me vendim të veçantë ka të drejtë të përcaktoj rregullat e hapjes dhe menaxhimit të rrjeteve sociale, si dhe platformave të transmetimit.

KAPITULLI IV

1. Sednice Skupštine ili odbora mogu biti delimično ili potpuno zatvorene, samo iz razloga predviđenih važećim zakonima.

2. Skupština opštine i skupštinski odbori obrazloženom odlukom objavljuju sednice potpuno ili delimično zatvorene za javnost.

POGLAVLJE III.

TRANSPARENTHOST IZVRŠNE VLASTI

Član 10.

Transparenthost izvršne vlasti

1. Gradonačelnik opštine obezbeđuje transparentnost svog procesa donošenja odluka, uprava i administracije.

2. Gradonačelnik opštine odgovoran je za sprovođenje propisa o objavljivanju izvršnih akata i službenih akata u skladu sa Zakonom br. 06/L-82 o zaštiti ličnih podataka i Zakonom br. 06/L-081 o pristupu javnim dokumentima.

3. Gradonačelnik opštine izveštava skupštinu opštine o ekonomsko-finanjskom stanju opštine i o sprovođenju investicionih planova opštine, najmanje jednom u šest meseci ili kad god to zahteva skupština opštine.

4. Gradonačelnik opštine posebnom odlukom ima pravo da utvrđuje pravila otvaranja i upravljanja društvenim mrežama, kao i platformama za emitovanje.

POGLAVLJE IV.

PUBLIKIMI I AKTEVE, DOKUMENTEVE ZYRTARE DHE FINANCIARE DHE AKTEVE TË TJERA TË KUQENDIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVIT

Neni 11

Publikimi i Akteve të Komunës

1. Komuna publikon të gjitha aktet e aprovuara nga kuvendi i komunës në ueb-faqen zyrtare pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim.
2. Komuna publikon në ueb-faqen zyrtare vendimet, urdhëresat e nxjerra nga kryetari i komunës.
3. Aktet dhe dokumentet e nxjerra nga drejtorit e komunës duhet të publikohen me qëllim të rritjes së transparencës.
4. Aktet dhe dokumentet e nxjerra nga paragrafi 1, 2 dhe 3 duhet të publikohen duke respektuar legjislacionin në fuqi përfshirë Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtën e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-81 për qasje në dokumente Publike.
5. Aktet dhe dokumentet nga parag.1, 2 dhe 3 të këtij neni publikohen nga njësia përgjegjëse për komunikim në komunë, në formë elektronike, në pajtim me dispozitat e legjislacionin Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
6. Komuna mund të shfrytëzoj edhe platforma të tjera për të publikuar aktet dhe dokumentet e nxjerra veçanërisht ato me karakter informues dhe vetëdijuese.

Neni 12

Publikimi i dokumenteve zyrtare

